# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5997
E premte, 7 shkurt 2020
çmimi 0.40 €


## Betohen anëtarët e rinj të KQZ-së
FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (PDK), ALEANCA PËR ARDHMËRINË E KOSOVËS (AAK) DHE NISMA SOCIALDEMOKRATE KANË REAGUAR LIDHUR ME IDENË QË TAKSA 100 PËR QIND NDAJ PRODUKTEVE SERBE TË ZËVENDËSOHET ME RECIPROCITET TË PLOTË POLITIK, EKONOMIK DHE TREGTAR FAQE 4-5

# TAKSA NDAJ SERBISË, 'BETEJA' E PARË POZITË - OPOZITË




Subjektet opozitare kanë kundërshtuar të enjten paraljmërimin e kryeministrit Albin Kurti për ta zëvendësuar taksën 100 për qind ndaj Serbisë me reciprocitet të plotë. Pavarësisht prej presionit ndërkombëtar për ta hequr këtë taksë, Kadri Veseli, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj kanë fuqar kryeministrin e ri që të mos merret me këtë çështje. Sipas tyre, taksa është një çështje e ndjeshme me të cilën nuk duhet të bëhen manovrime politike

## OPINION

### QEVERIA KURTI, NDËRMJET PREMTIMEVE, REALITETEVE DHE PRESIONEVE F. 10-11

Prof. Lisen BASHKURTI



## AKTUALE



### BLERIM REKA PRANON DETYRËN E MINISTRIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN F. 7

### KATËR KOMUNA PEZULLOJNË MËSIMIN PËR SHKAK TË MOTIT TË LIG F. 6

# ERËRAT E FUQISHME SHKAKTOJNË DËME TË MËDHA NË ISTOG, PEJË DHE KLINË

Si pasojë e erërave të forta në komunën e Istogut, të Pejës dhe të Klinës janë rrëzuar shumë kulme shtëpish, janë dëmtuar prona private dhe biznese dhe janë rrëzuar shtyllat e rrjetit elektrik. Dëmet janë të mëdha, sidomos në Istog, ku është ndërprerë edhe mësimi në shkolla. Kryeministri Albin Kurti sot (e premte) do ta vizitojë komunën e Istogut, të Pejës dhe të Klinës FAQE 7





## EKONOMI

### ATK-ja VETËM NË JANAR MBLODHI MBI 67 MILIONË EURO F. 9

### GAP-i: QEVERIA KURTI DO TË KURSEJË 13 MILIONË EURO NË VITIN E PARË TË MANDATIT F. 8

## Kuvendi, me 14 komisione parlamentare
FAQE 3

## SPORT

### FETAHAJ: DUKAGJINI I RREZIKSHËM, POR BALLKANI KUALIFIKOHET NË GJYSMËFINALE F. 20




RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Meta: Zoti e bekoftë miqësinë shqiptaro-amerikane!

PRISHTINË, 6 SHKURT - Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, gjatë vizitës në Shtetet e Bashkuara të Amerikës është takuar me Sekretarin amerikan të Shtetit, Michael Pompeo. Kreu i shtetit shqiptar dhe shefi i diplomacisë amerikane kanë ndjekur së bashku fjalën e presidentit të ShBA-së, Donald Trump në Mëngjesin e Lutjeve në Uashington D.C.
Në një mesazh në Facebook, Ilir Meta shprehet se ndan të njëjtin mendim me vlerësimin "që bëri presidenti Trump për rolin e veçantë të Sekretarit Pompeo dhe ambasadorit të posaçëm Sam Brownback për Aleancën Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Avancimin e Lirive Fetare". "Kënaqësi të ndiqnim së bashku me Sekretarin amerikan të Shtetit, Michael Pompeo, fjalën e presidentit të ShBA-së, Donald Trump në Mëngjesin e Lutjeve në Uashington D.C. Edhe unë bashkohem me vlerësimet më të mira që bëri presidenti Trump për rolin e veçantë të Sekretarit Pompeo dhe ambasadorit të posaçëm Sam Brownback për Aleancën Ndërkombëtare për Mbrojtjen dhe Avancimin e Lirive Fetare. Krenar për modelin tonë të shkëlqyer të harmonisë fetare dhe mbështetjes që i japim lirisë së besimit kudo në botë. Zoti e bekoftë miqësinë shqiptaro-amerikane", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".



# Kriza Rusi - Ukrainë dërgon Ramën në Rusi

Në kuadër të kryesimit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, këtë muaj do të zhvillojë një vizitë në Rusi, por mbetet e paqartë se kush do të jenë bashkëbiseduesit e tij në Moskë, ku në fokus të bisedimeve do të jetë kriza Rusi - Ukrainë



TIRANË, 6 SHKURT - Në kuadër të kryesimit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, do të zhvillojë një vizitë në Rusi. "Top Channel", duke iu referuar burimeve diplomatike të OSBE-së në Vjenë, thotë se kjo vizitë është parashikuar për datën 26 shkurt.
Mbetet e paqartë për momentin se kush do të jenë bashkëbiseduesit e tij në Moskë, ku në fokus të bisedimeve do të jetë kriza Rusi - Ukrainë.
Në fjalimin e tij përpara Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, kryeministri Rama e listoi Ukrainën si një prej prioriteteve të presidencës shqiptare të OSBE.
I fundit kryeministër shqiptar që ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Moskë duke u takuar me kryeministrin e atëhershëm Çernomerdin, është Aleksandër Meksi gati një çerek shekulli më parë.
Vetë Meksi ka deklaruar më vonë se pritja atje qe e madhe. "Nga delegacioni shqiptar kishte pak njerëz. Sa fillova të flisja rusisht ata u habitën dhe më duartrokitën. Kryeministri rus Çernomerdin mu afrua dhe ne bëmë një bisedë të lirë. Më tej ai më tha se mund t'i shiste Shqipërisë avionë luftarakë MIG me çmim të lirë. Unë i ktheva përgjigjen: Mirë, por na gjeni armikun fillimisht", ka treguar ish-kryeministri Meksi.
Kjo vizitë e kryeministrit Edi Rama në Kremlin, zhvillohet në një kohë kur marrëdhëniet mes Shqipërisë dhe Rusisë janë në kuotat minimale. Në mars të vitit 2018 Shqipëria iu bashkua vendeve evropiane duke dëbuar dy diplomatë rus nga Tirana, një veprim i koordinuar edhe me NATO-n.
Ata ishin Vladislav Filipov, atashe ushtarak dhe Alexey Nikolaevich Balashov, sekretar i parë i Ambasadës, të dyshuar se nën petkun e diplomatit zhvillonin spiunazh për interesa të Rusisë.
Megjithëse Edi Rama e viziton Moskën si kreu i OSBE-së, kjo do të jetë një mundësi e mirë për t'i dhënë një qasje të re marrëdhënieve mes dy vendeve.
Ndërkohë, në fjalën e mbajtur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, kryeministri Edi Rama bëri me dije pikat kyçe ku do të fokusohet Shqipëria gjatë drejtimit të OSBE-së për vitin 2020.
Rama theksoi se parësore për Shqipërinë gjatë kryesimit të OSBE-së do të jetë siguria kombëtare, respektimi i të drejtave të njeriut dhe forcimi i shtetit të së drejtës.
Më tej ai shtoi se mbrojtja dhe diferenca në terren përmes monitorimit të OSBE-së është një nga pikat kyçe që Shqipëria ka gjatë kryesimit për 2020.
"OSBE-ja është një shtyllë e rëndësishme e rendit ndërkombëtar dhe në axhendën tonë është zhvillimi i qëndrueshëm.
Jam i vendosur si kryetar i OSBE-së për të rritur bashkëpunimin dhe të përballimin e sfidave. Pikat kyçe janë siguria kombëtare dhe të promovojmë të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtësi", tha ai.
Rama tha se në krye të OSBE-së objektivi kryesor do të jetë mbrojtja dhe të bëjmë diferencën në terren. "OSBE-ja ka provuar se mund të dislokohet në vende të ndryshme pas konfliktit, prandaj përpjekjet për zgjidhjen e krizave mbetet parësore për ne si kriza në Ukrainë. Gjatë vizitës në Ukrainë theksova përkushtimin tonë për të çuar përpara marrëveshjen e paqes dhe arritjen armëpushimit atje. Pavarësisht marrëveshjes së paqes ende ka viktima atje. Në Ukrainë kërkojnë një monitorim të OSBE-së atje për zbatimin e plotë të paqes", tha Rama.

## Basha: Qeveri transitore pa Ramën kryeminister

TIRANË, 6 SHKURT - Lideri i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka nisur një formë të re komunikimi me qytetarët, duke iu përgjigjur pyetjeve të tyre në rrjetet sociale.
Lideri i PD-së, Lulzim Basha, deklaroi se opozita jashtëparlamentare i qëndron ende idesë për krijimin e qeverisë transitore pa kryeministrin Rama, duke u hapur rrugë zgjedhjeve të parakohshme.
Teksa iu është përgjigjur pyetjeve të tyre, Basha tha se qëllimi i PD-së është që vendit t'i kthehet besimi në ekonomi. "Po, votimi elektronik dhe numërimi elektronik janë një nga pikat që do të kërkohen nga PD-ja dhe opozita e bashkuar. Ne kemi parë se si mund të ndërtohet një sistem i tillë. Votimi elektronik garanton që procesi të jetë i barabartë. Rama është gati që ta shkatërrojë procesin zgjedhor që ta mbajë pushtetin. Ne i kemi parashtruar më 16 shkurt të vitit të kaluar kërkesën për zgjedhje të parakohshme. Na japin dhe leksione. Ata janë hajdutë të zgjedhjeve. Qeveria transitore është garanci dhe pa Ramën kryeministër", tha Basha.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Kuvendi, me 14 komisione parlamentare



Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës të enjten ka diskutuar lidhur me formimin e komisioneve parlamentare si dhe për aspekte të tjera të funksionalitetit të punës në Kuvend. Kryesia e Kuvendit vendosi që numri i komisioneve parlamentare të mbetet 14, ndërsa bëri disa ndryshime në emërtime dhe përgjegjësitë e tyre. Përzgjedhja e komisioneve nga ana e grupeve parlamentare pritet të bëhet në mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës në mbledhjen e së enjtes, të drejtuar nga Vjosa Osmani, kryetare, në të cilën ishin të pranishëm edhe kryetarët e grupeve parlamentare, diskutoi lidhur me formimin e komisioneve parlamentare si dhe për aspekte të tjera të funksionalitetit të punës në Kuvend. Fillimisht, kryeparlamentarja Osmani u shprehu anëtarëve të kryesisë dhe kryetarëve të grupeve parlamentare urime për detyrat e tyre, njëkohësisht shfaqi interesimin dhe gatishmërinë e plotë për bashkëpunim në funksion të avancimit të punës së Kuvendit dhe interesit të qytetarëve.

Duke hyrë në rend dite, Kryesia vendosi që numri i komisioneve parlamentare të mbetet 14, ndërsa bëri disa ndryshime në emërtime dhe përgjegjësitë e tyre, si në vijim: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, Komisioni për Integrim Evropian, Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, Komisioni për Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media, Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike, Komisioni për Çështjet e Sigurisë dhe Mbrojtjes, Komisioni për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis, Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë.

Përzgjedhja e komisioneve nga ana e grupeve parlamentare pritet të bëhet në mbledhjen e radhës të Kryesisë. Gjatë kësaj mbledhjeje, Kryesia e Kuvendit u njoftua edhe lidhur me kërkesën e Thesarit të shtetit përkitazi me buxhetin. Kryetarja Osmani bëri me dije se Kuvendi është në pritje të vendimit të qeverisë nëse do ta procedojë Projektligjin për buxhetin apo vendimin për zgjatjen buxhetore edhe për muajin mars.

Me propozim të kryetares Osmani, Kryesia u pajtua, po ashtu, që Kuvendi të ndërtojë një agjendë të rregullt pune, duke e përcaktuar të hënën si ditë për mbledhje të Kryesisë, ndërsa të enjten të mbahen mbledhjet plenare të Kuvendit. Ndër të tjera, Kryesia e Kuvendit ka diskutuar edhe për funksionalizimin e bordeve të disa institucioneve të pavarura, për hapësirat e punës për deputetë, për lehtësimin e qasjes në hapësirat e Kuvendit të personave me nevoja të veçanta si dhe çështje të tjera nga fushëveprimtaria e saj.

# Betohen anëtarët e rinj të KQZ-së



Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka emëruar të enjten anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), sipas propozimeve të grupeve parlamentare dhe të partive politike parlamentare të komuniteteve të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 6 SHKURT - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të enjten e ka kompletuar përbërjen e re të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas propozimeve të grupeve parlamentare dhe të partive politike parlamentare të komuniteteve të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës, sot e kanë dhanë betimin para presidentit Thaçi se do t'i kryejnë me nder detyrat e tyre. "Anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve sot e dhanë betimin se do t'i kryejnë në mënyrë të ndershme, besnike, të paanshme, profesionale dhe të ndërgjegjshme të gjitha detyrat e tyre", ka thënë presidenti Thaçi.

Këta janë anëtarët e rinj të Komisionit Qendror Zgjedhor të cilët dhanë betimin para presidentit Thaçi: 1. Sami Kurteshi (LV), 2. Alim Rama (LV), 3. Sami Hamiti (LDK), 4. Arianit Elshani (PDK), 5. Ibrahim Selmanaj (AAK), 6. Nenad Rikalo (Iniciativa Qytetare Lista Serbe), 7. Eshref Vishi (koalicioni Nisma-AKR-PD), 8. Cemailj Kurtisi (koalicioni VAKAT), 9. Rifat Krasnic (KDTP) dhe 10. Artan Asllani (PAI).

Anëtarët e rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve u betuan se do t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të ndershme, besnike, të paanshme, profesionale dhe të ndërgjegjshme. Në këtë ceremoni ishte e pranishme edhe kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka.

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nisma Socialdemokrate kanë reaguar lidhur me idenë që taksa 100 për qind ndaj produkteve serbe të zëvendësohet me reciprocitet të plotë politik, ekonomik e tregtar

# Taksa ndaj Serbisë, 'beteja' e parë pozitë - opozitë




**Subjektet opozitare kanë kundërshtuar të enjten paralajmërimin e kryeministrit Albin Kurti për ta zëvendësuar taksën 100 për qind ndaj Serbisë me reciprocitet të plotë. Pavarësisht prej presionit ndërkombëtar për ta hequr këtë taksë, Kadri Veseli, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj kanë ftuar kryeministrin e ri që të mos merret me këtë çështje. Sipas tyre, taksa është një çështje e ndjeshme me të cilën nuk duhet të bëhen manovrime politike**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 SHKURT - Paralajmërimi i kryeministrit Albin Kurti për ta zëvendësuar taksën prej 100 përqindësh ndaj Serbisë me reciprocitet, ka nxitur reagime të fuqishme të partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Socialdemokrate. Tre liderët e partive opozitare, Kadi Veseli, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj, e kanë kundërshtuar një gjë të tillë, duke vlerësuar se taksa 100 për qind ndaj produkteve serbe është një temë e ndjeshme dhe nuk duhet të bëhen manovrime me të. Më i ashpri në këtë drejtim ka qenë ish-kryeministri Ramush Haradinaj, i cili me fanatizëm e kishte mbrojtur taksën ndaj Serbisë gjatë qeverisjes së tij.

Përmes një letre publike drejtuar Kurtit, në të cilën ia ka përmendur sakrificat e kryeministrit të ri, Haradinaj e ka lutur Kurtin që të mos e heqë taksën. "Ne mund të mos pajtohemi për shumë gjëra të politikës ditore, por sakrificën gjithmonë ta kam njohur. Për shkak të kësaj sakrifice dua që personalisht të lutem të mos e heqësh taksën ndaj Serbisë. Albin, mos e lejo tregun e fitimit të mbi 400 milionë eurove për Serbinë, shtetin i cili të ka rrahur e të ka torturuar. Shtetin që me paratë e popullit të Kosovës blen armë në Rusi. Të lutem, mos e kamuflo këtë vendim sovran me terme të mjegullta siç është 'reciprociteti'", ka shkruar Haradinaj.

Ai ka bërë me dije se çështja e taksës është më e madhe se disa lëvdata ndërkombëtare dhe se një grusht vota. "Mos e heq taksën, Albin. Mos u tërhiq për disa poenë të përkohshëm që mund t'i fitosh nga bashkësia ndërkombëtare. Miku që është mik i vërtetë të do e të ndihmon me lavd, por edhe me kritika. Nëse nuk jemi të zotët e vetes, nuk na do as miku. Rikonsideroje vendimin Albin. Ne mund të vazhdojmë të mos pajtohemi. Për këto mospajtime sovrani ka dhënë verdiktin më 6 tetor, por kjo është një temë më e madhe sesa një grusht vota. Albin, ne të dy kemi kaluar nëpër rrugë të vështira. Ne garojmë dhe do ta vazhdojmë garën politike. Nuk kemi arritur deri këtu ku jemi si Kosovë me taktizime të përkohshme, por me sakrificë e qëndrueshmëri", ka shkruar Haradinaj në këtë letër publike, duke shtuar se në kundërshtim të Serbisë duhet të jenë bashkë deri në njohje reciproke e jo të jesh për një "reciprocitet" pa njohje.

Edhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka kundërshtuar paralajmërimin e Kurtit për heqjen e taksës. Në profilin e tij në "Facebook", ka shkruar se ndihet i shqetësuar për ngutin e tepruar të kryeministrit të ri për t'i përmbushur kërkesat e Serbisë dhe për ta rehatuar Listën Serbe. "Taksa ndaj importeve serbe ka qenë vendim dinjitoz i shtetit tonë për t`iu kundërvënë sulmeve të njëpasnjëshme që Serbia ka bërë kundër Kosovës. Shpreh shqetësimin për ngutin e tepruar të kryeministrit të ri për t'i përmbushur kërkesat e Serbisë dhe për ta rehatuar Listën Serbe, e cila u largua nga qeveria e kaluar për shkak të taksës", ka shkruar Veseli.

Sipas tij, qeveria e re duhet të mos të dorëzohet para Serbisë dhe vendimeve të mëdha që e presin Kosovën. "Një qeveri ka rënë si pasojë e taksës, gjë që ka dobësuar për një kohë Kosovën. Prandaj, nuk duhet të ketë manovrime politike për këtë temë të ndjeshme, e cila rrezikon ta dëmtojë më tej vendin tonë. Qeveria e re duhet të mos të dorëzohet para Serbisë, përpara sfidave dhe vendimeve të mëdha që e presin Kosovën", ka shkruar Veseli

Ndërsa kreu i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se kryeministri Kurti nuk duhet të fliste për temën e taksës në ditën e tij të parë si kryeministër i shtetit. Ai ka deklaruar se ka qindra tema të tjera me të cilat duhet të merret kryeministri para se të flasë për taksën ndaj Serbisë. "Kryeministri nuk duhet të flasë për temën e taksës në ditën e tij të parë si kryeministër i shtetit. Ka ma shumë se 100 tema të tjera me të cilat mund të merret. Tema e taksës është temë e ndjeshme", ka thënë Limaj.

Një ditë më parë kryeministri i →

Kosovës, Albin Kurti dhe kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, kanë paralajmëruar zëvendësimin e taksës 100 për qind ndaj produkteve serbe me reciprocitetin e plotë politik, ekonomik e tregtar. I pari i qeverisë ka thënë se në Kosovë ekziston një mendim i përgjithshëm për vendosje të reciprocitetit me Serbinë. "Jemi këtu ku jemi si qeveri e re edhe për shkak të zotimit tonë që me Serbinë do të kemi reciprocitet ekonomik, politik e tregtar, si zëvendësim të tarifës 100 për qind", ka thënë Kurti. Sipas tij, reciprociteti do ta forconte subjektivitetin e shtetit të Kosovës ndaj Serbisë. "Pra, ne nuk themi që do të kthehemi në marrëdhënie asimetrike me Serbinë, përkundrazi do të avancojmë duke e shndërruar subjektivitetin tonë në çështje integriteti e dinjiteti, me parimin i cili më së shumti njihet për vlerën e tij në raportet ndërfqinjësore e bilaterale, e ky është reciprociteti", është shprehur Kurti.

Ndërsa kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se kjo duhet të ndodhë pas ndërprerjes së fushatës së Serbisë ndaj shtetit të Kosovës. "Programi i përbashkët i koalicionit është prezantuar nga kryeministri Albin Kurti në Kuvend më 3 shkurt dhe aty është bërë e qartë, siç e kemi thënë, se tarifa të zëvendësohet me masat e reciprocitetit. Për t'u larguar kjo tarifë, siç edhe e ka thënë ambasadori amerikan Grenell, Serbia duhet ta ndërpresë fushatën e çnjohjeve, që po bën përmes metodave ilegale, që e ka minuar rëndësinë e dialogut", ka deklaruar Osmani.

Një ditë pasi që Kuvendi i Kosovës ka votuar për formimin e qeverisë së re me Albin Kurtin kryeministër, i dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, i ka bërë thirrje Qeverisë së re të Kosovës që të heqë taksën ndaj mallrave të importuara nga Serbia.

## Xhelal Sveçla, zëvendësministër i parë i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike



PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, të enjten e ka emëruar Xhelal Sveçlën zëvendësministër të parë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, të cilit i ka uruar punë të mbarë dhe suksese të vazhdueshme. Ai ka thënë se për qeverinë që drejton është jetike që rendi, ligji dhe siguria në vend, por edhe rregulli dhe efikasiteti nëpër institucione, të rriten dhe të përmirësohen.

# Kosovës po i plaket stafi mjekësor



PRISHTINË, 6 SHKURT - Pensionimi i mjekëve në Kosovë, krahas dukurisë së ikjes së shtuar të mjekëve nga brezi i ri, ka bërë që të ndihet mungesa e stafit shëndetësor. Mosha mesatare e mjekëve familjarë në Kosovë ka arritur në 57 vjeç, derisa e mjekëve specialistë në rreth 53 vjeç. Këto të dhëna i ka paraqitur Federata Sindikale e Shëndetësisë.

Profesionistë të fushës së shëndetësisë thonë se në dhjetë vjetët e ardhshëm do të ketë një krizë profesionale mjekësore pasi që, siç thonë ata, një mjekut i duhen së paku 15 vjet që të pavarësohet në punë profesionale.

Njëri nga spitalet rajonale që tashmë po vuan mungesën e mjekëve është ai i Gjakovës. Drejtori i këtij spitali, Hilmi Shala, i tha "Radios Evropa e Lirë" se si pasojë e pensionimit të mjekëve tashmë ka edhe reparte që janë mbyllur ngaqë nuk janë gjetur zëvendësime. Gjithashtu, edhe shumë klinika të tjera brenda këtij spitali, tha ai, kanë mungesë të mjekëve. "Kemi nevojë për profile të ndryshme. Për shembull, Reparti i Oftalmologjisë është mbyllur për shkak se dy mjekë që kanë punuar aty kanë dalë në pension. Gjithashtu, Reparti i Otorinolaringologjisë aktualisht funksionon me një mjek, pasi një tjetër ka dalë në pension. Kemi nevojë për biokimistë, infektologë, mjekë të emergjencës etj. Gjithashtu, është një kirurg që së shpejti do të dalë në pension dhe do të ndihet mungesa e tij", tha Shala.

Në anën tjetër, kryetari i Federatës Sindikale të Shëndetësisë, Blerim Syla, ka bërë me dije se duke e parë trendin e pensionimit, por edhe duke u bazuar në moshën mesatare të mjekëve, Kosova në pesë deri në dhjetë vjetët e ardhshëm do ta përjetojë një krizë 'të paparë' profesionale. "Mosha mesatare e mjekëve familjarë, sipas Asociacionit të Mjekëve, ka arritur në 57 vjeç, kurse mosha e pensionimit është 65 vjeç. Dhe nëse e shohim që kemi minus 200 mjekë, kjo na dërgon në konkludimin se shumë shpejt do të mbesim pa mjekë familjarë. Ndërkaq te mjekët specialistë mosha mesatare është rreth 53 vjeç, andaj në dhjetë vjetët e ardhshëm do të kemi krizë", tha Syla. Sipas tij, aktualisht po punohet në atë drejtim që t'u mundësohet mjekëve të aftë fizikisht dhe me shëndet të mirë, që edhe pas pensionimit të mund të punojnë, sidomos aty ku rrezikohet të mbyllet ndonjë repart i caktuar. "Jemi duke punuar me Odën e Mjekëve që të nxjerrim një udhëzim administrativ, që t'i angazhojmë mjekët që janë në pension në ato vende ku ka nevojë, por që janë në gjendje të mirë fizike dhe psikike. Pra, nuk jemi në një situatë të lakmueshme, pasi si kuadër jemi duke u plakur", shtoi Syla.

Ndërsa kryetari i Odës së Mjekëve, Pleurat Sejdiu, tha se si institucion nuk kanë ndonjë statistikë se sa mjekë pensionohen brenda një viti, por tha se rreth 100 mjekë të pensionuar tashmë vazhdojnë të punojnë në sektorin privat shëndetësor.

Krahas plakjes së stafit, ai e veçon edhe ikjen e mjekëve jashtë Kosovës, duke e cilësuar shqetësuese mundësinë e mungesës së theksuar të mjekëve në vitet e ardhshme. "Numri i atyre që po pensionohen është i madh, nëse krahasohet me numrin e të punësuarve, pasi mosha mesatare është rreth 53 vjeç e forcës punuese, pra e atyre që punojnë. Por, tashmë është alarmante edhe ikja e mjekëve jashtë vendit. Pra, nuk kemi zgjidhje tjetër, pos të zëvendësohen me mjekë të rinj", tha Sejdiu.

Ndryshe, më shumë se 600 mjekë në Kosovë janë të papunë, prej të cilëve, sipas statistikave të Odës së Mjekëve të Kosovës, 60 janë mjekë specialistë. Institucionet publike shëndetësore, në anën tjetër, kanë kumtuar se kanë nevojë edhe për pesë mijë mjekë të rinj që të punësohen.

Ndërkohë në Odën e Mjekëve të Kosovës, gjatë vitit 2019, thuhet se 115 mjekë kanë kërkuar dokumente për punësim jashtë Kosovës.

Numri më i madh i tyre, bazuar në Odën e Mjekëve, kanë qenë mjekë të rinj, të cilët nuk kanë mundur të punësohen në Kosovë në profesionin e tyre, ndonëse sistemi shëndetësor ka mungesë të vazhdueshme të mjekëve.

# Katër komuna pezullojnë mësimin për shkak të motit të lig

**Prishtinë, 6 shkurt (ER)** - Shkollat e komunës së Dragashit, të Klinës, të Istogut dhe të Kamenicës të enjten nuk kanë mbajtur mësim për shkak të motit të ligë. Lajmin e ka bërë me dije Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MAShT). "Sipas informatave nga terreni, në shkollat e Istogut, Klinës, Kamenicës dhe Dragashit, gjatë ditës së sotme nuk po zhvillohet mësimi. Në Prishtinë punojnë të gjitha shkollat, përveç shkollave 'Mitrush Kuteli' dhe 'Tefik Çanga'. Në Lipjan nuk punohet sot vetëm në shkollat 'Ibrahim Krasniqi' - Smallushë dhe 'Rexhep Aklapi' - Akllap, ndërsa në Mitrovicë nuk punohet në katër shkolla. Në Shtime (Pjetërshticë), shkolla 'Idriz Ajeti' punon me orar të shkurtuar, sikur edhe në Ferizaj ku shkollat po punojnë me vështirësi dhe disa prej tyre me orar të shkurtuar. Po ashtu, në Prizren mësimi po zhvillohet me vështirësi në zonat e thella malore, si Nëpërgosht, Manastericë dhe Llukfcë. Ndërsa në Pejë janë pesë shkolla ku nuk po zhvillohet mësimi. Në Komunën e Vitisë mësimi nuk ka filluar në ndërrimin e parë në shkollat 'Mirali Sejdiu' në Gërmovë dhe 'Hysen Tërpeza' në Tërpezë për shkak të ndërprerjes së rrymës, por pritet të mbahet mësimi në ndërrimin e dytë", është thënë në njoftimin e MAShT-it.



# Klinika e Neonatologjisë në Mitrovicë bëhet me pajisje mjekësore për foshnja

**Mitrovicë, 6 shkurt (ER)** - Action for Mothers and Children, bashkë me organizatorët e Cycle Kosovo for Children, të enjten dorëzuan pjesën e dytë të pajisjeve mjekësore për foshnja në repartin e neonatologjisë në spitalin e Mitrovicës. Pajisjet u siguruan nga fondet e ngritura nga turneu vendor Cycle Kosovo for Children, e cila është një ngjarje bamirëse vjetore e çiklistëve në Kosovë, që organizohet për të ngritur fonde për fondacionin Action for Mothers and Children. Kujtojmë se pjesa e parë e pajisjeve mjekësore u dorëzua në po të njëjtin spital në fund të vitit të kaluar.




Ky aktivitet i çiklistëve të Cycle Kosovo for Children, i organizuar gjatë vitit 2019, ishte i gjashti me radhë dhe në të morën pjesë rreth 30 çiklistë në rrugëtimin katërditor, ku u siguruan rreth 10 000 euro përmes kontributeve të kompanive, individëve dhe përmes fushatave online.

Ky aktivitet do të organizohet edhe këtë vit përgjatë muajit qershor, me ç'rast fondet e ngritura do të ndihmojnë spitale apo klinika të tjera të cilat identifikohen që kanë nevojë të mbështeten me pajisje të reja mjekësore. "Ne jemi jashtëzakonisht falënderues ndaj Cycle Kosovo for Children, të cilët çdoherë janë shprehur të gatshëm të na ndihmojnë për përmbushjen e misionit tonë. Sikurse në vitet e kaluara, edhe këtë vit do të angazhohemi bashkërisht me organizatorët e CKC që të ngrehim sa më shumë fonde në mënyrë që ta ndihmojmë sistemin shëndetësor në Kosovë, me fokus të veçantë te sektorët që mbulojnë shëndetin e nënave dhe fëmijëve", është shprehur Vlorian Molliqaj, drejtor ekzekutiv i Fondacionit Action for Mothers and Children.

Action for Mothers and Children njofton që të gjitha fondet që ngritën përgjatë vitit 2020 do të dyfishohen deri në vlerën prej 50 mijë eurosh falë iniciativës së punëtorëve të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

# Situata e sigurisë në Malishevë, në nivel të mirë

**Malishevë, 6 shkurt (ER)** - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Malishevë ka mbajtur mbledhjen e parë për vitin 2020, e cila është drejtuar nga nënkryetari i këtij komune, Hajdin Berisha. Në këtë takim situata e sigurisë së përgjithshme është vlerësuar të jetë e mirë dhe pa tendencë të prishjes së kësaj situate. Në raportimet e tyre, anëtarët e KKSB-së, në veçanti organet e sigurisë, kanë thënë se siguria është në nivel të lartë.

Komandanti i Stacionit Policor në Malishevë, kapiteni Azem Krasniqi, gjatë raportimit të tij ka thënë se ka rënie të veprave penale, ndërsa edhe rastet e vjedhjeve kanë rënë për 50 për qind në raport me vitin paraprak. Ai ka thënë se gjatë vitit të kaluar ka ndodhur vetëm një vrasje. Sipas tij, për krijimin e kësaj sigurie për qytetarët kanë ndikuar një varg faktorësh, duke filluar nga bashkëpunimi i mirë me qytetarët dhe institucionet relevante, pastaj vendosja e kamerave të sigurisë në qytet dhe ndriçimi publik nëpër vendbanime.

Edhe anëtarët tjerë të KKSB-së e kanë vlerësuar të mirë situatën e sigurisë dhe kanë përgëzuar organet e rendit për punën e palodhshme që janë duke bërë, me qëllim të ruajtjes së sigurisë së përgjithshme. Në këtë mbledhje, KKSB-ja ka shqyrtuar dhe miratuar planin e punës për vitin 2020. Në fund të takimit, anëtarët e KKSB-së kanë paraqitur shqetësimin e tyre për numrin e madh të qenve endacakë, të cilët, sipas tyre, mund të paraqesin rrezik për qytetarët, në veçanti për fëmijët.



## Komuna e Skenderajt organizon takim informues për legalizimin e ndërtimeve

Skenderaj, 6 shkurt (ER) - Komuna e Skenderajt ka njoftuar se më 11 shkurt do ta mbajë një takim informues me qytetarët e kësaj komune për çështjen e legalizimeve të ndërtimeve. "Të dashur qytetarë të Skenderajt, me qëllim të informimit tuaj në lidhje me procedurat për legalizimin e ndërtimeve tuaja, shtëpive dhe ndërtesave, Komuna e Skenderajt do ta mbajë takimin e parë me qytetarë, më datën 11. 02. 2020, duke filluar nga ora 13:30, në sallën e Kuvendit Komunal. Me ligjin e trajtimit të ndërtimeve pa leje do të trajtohen të gjitha ndërtimet e ndërtuara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji më 05. 09. 2018. Taksa për legalizimin e ndërtimit është shumë e lirë, 1 euro për m2 për kategorinë 1 (shtëpi) dhe 2 euro për m2 për kategorinë 2 (ndërtesa). Ndërtimi juaj pas legalizimit nuk rrezikon të rrënohet!", ka njoftuar Komuna e Skenderajt.



# Erërat e fuqishme shkaktojnë dëme të mëdha në Istog, Pejë dhe Klinë

Si pasojë e erërave të forta në komunën e Istogut, të Pejës dhe të Klinës janë rrëzuar shumë kulme shtëpish, janë dëmtuar prona private e biznese dhe janë rrëzuar shtyllat e rrjetit elektrik. Dëmet janë të mëdha, sidomos në Istog, ku është ndërprerë edhe mësimi në shkolla. Kryeministri Albin Kurti sot (e premte) do ta vizitojë komunën e Istogut, të Pejës dhe të Klinës





EPOKA E RE Faton DËRMAKU

KLINË, ISTOG, PEJË, 6 SHKURT - Moti i lig, me erëra të fuqishme që ka përfshirë Istogun, Pejën dhe Klinën, ka shkaktuar dëme të mëdha në këto tri komuna të Dukagjinit. Po ashtu, erërat e fuqishme kanë shkaktuar dëme materiale dhe në komunën e Drenasit. Pas këtyre erërave, Komuna e Istogut ka mbledhur të enjten Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim, komandantin e Stacionit Policor në Istog, Forcën e Sigurisë së Kosovës, përfaqësuesit e KEDS-it, si dhe të gjitha drejtoritë përkatëse. Me këtë rast, kryetari i Istogut, Haki Rugova, ka formuar komisionet për vlerësimin e gjendjes të institucioneve publike, vlerësimin e gjendjes të infrastrukturës rrugore, si dhe vlerësimin e gjendjes në bujqësi. "Sa i përket vlerësimit të dëmeve të shtëpive private, do të formohet komision i veçantë e cili së shpejti do të dalë në terren për konstatimin e dëmeve", ka njoftuar Komuna e Istogut.

Edhe Komuna e Pejës, përkatësisht Bordi i Drejtorëve, ka mbajtur një mbledhje emergjente në të cilën janë paraqitur informata për dëmet e shkaktuara në shkolla, qendrat mjekësore, objektet bujqësore, gjendjen e rrugëve, dëmet në prona private, në zyrat administrative, objektet sportive dhe kulturore etj. Me këtë rast, ky bord ka krijuar shtabin e emergjencës, i cili do të pranojë dhe shqyrtojë kërkesat e qytetarëve në raport me dëmet e shkaktuara nga erërat e forta. "Ekipet emergjente do të dalin në terren gjatë gjithë kohës për t'i



vlerësuar situatat e krijuara nga erërat. Qytetarët që kanë pësuar dëme nga erërat e forta këshillohen që të bëjnë fotografi, ta përshkruajnë dëmin dhe ta dorëzojnë në Drejtorinë e Emergjencës dhe ekspertët do ta shqyrtojnë lëndën. Bazuar në dëmet e raportuara deri tani, duket se dëmet janë të mëdha. Meqenëse komuna i ka kapacitetet e kufizuara financiare, në ditët në vijim do t'i drejtohemi edhe nivelit qendror për të kërkuar ndihmë që të riparohen dëmet e shkaktuara", ka njoftuar Komuna e Pejës.

Erërat e fuqishme kanë shkaktuar dëme edhe në Komunën e Drenasit. Me këtë rast, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë të enjten ka dalë në terren për t'i shënuar dëmet e shkaktuara nga erërat. "Si pasojë e erërave të forta që kanë përfshirë vendin, janë shënuar dëmtime në disa shtëpi banimi në disa prej fshatrave të Drenasit. Ekipi përkatës komunal është në vend të ngjarjes dhe po monitoron gjendjen dhe po shënon dëmet", ka njoftuar Komuna e Drenasit.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) ka njoftuar se është i gatshëm që në aspektin e shëndetësisë t'u ndihmojnë qytetarëve në zonat e Istogut, Klinës dhe Pejës, të cilat janë të dëmtuara nga erërat e forta. "Ekipi i Institutit është duke ndërmarrë masat e duhura dhe është i gatshëm që në ditët në vijim të kujdeset për qytetarët tanë dhe t'i vlerësojë rreziqet për shëndet në situatën e krijuar, veçmas nga ndërprerjet e ujit e të rrymës. Me kujdes po monitorohet uji i pijshëm në Pejë dhe Istog", thuhet në njoftimin e IKShPK-së.



## Kryeministri Kurti sot viziton komunën e Istogut, të Pejës dhe të Klinës

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ka reaguar pas erërave të forta në komunën e Istogut, të Pejës dhe të Klinës, të cilat kanë shkaktuar dëme të mëdha materiale. "Qytetarët e Kosovës, që banojnë në komunën e Istogut, e në disa pjesë të Klinës e të Pejës, duhet të kenë kujdes këto ditë. Era e fortë ka rrëzuar kulme shtëpish, ka dëmtuar prona private e biznese, ka rrëzuar shtyllat e rrjetit elektrik. Dëmet kanë qenë të mëdha, sidomos në Istog, ku është ndërprerë edhe mësimi në shkolla. Për fat të mirë nuk jemi njoftuar për të lënduar", ka thënë kryeministri Kurti. Me këtë rast, kryeministri Kurti ka thënë se Qeveria e Kosovës do ta ketë vëmendjen e nevojshme ndaj kësaj situate për t'i vlerësuar sfidat dhe për t'i marrë masat e duhura, për t'iu gjendur pranë qytetarëve tanë. Kryeministri Kurti ka bërë me dije se sot (e premte) do të vizitojë komunën e Istogut, të Pejës e të Klinës për të parë nga afër situatën e për të dëgjuar se cilat janë nevojat e institucioneve dhe ato të qytetarëve.



## Blerim Reka pranon detyrën e ministrit të Integrimit Evropian

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Në kuadër të ceremonisë së pranim-dorëzimit të përgjegjësive të Ministrisë së Integrimit Evropian, ish-ministrja Dhurata Hoxha dorëzoi zyrtarisht detyrën te ministri i porsaemëruar, Blerim Reka.

Ministri i Integrimit Evropian, Blerim Reka, ka falënderuar Hoxha për punën dhe përkushtimin e gjertanishëm. Me këtë rast, ministri Reka tha se me emërimin e tij ministër i Integrimit Evropian të Republikës së Kosovës është nder dhe përgjegjësi dhe do të përkushtohet maksimalisht për përmbushjen e agjendës evropiane dhe përshpejtimit të gjithë procesit të integrimit evropian.

Ministri Reka potencoi se gjatë mandatit të tij do të ofrojë transparencë të plotë dhe ligjshmëri si dhe koordinim dhe komunikim maksimal me qytetarët, palët e interesuara, shoqërinë civile dhe mediat.

Në biografinë e tij, ministri Reka ka përvojën si diplomat dhe profesor. Gjatë periudhës 2006-2010 ka qenë ambasador i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian, në Bruksel, ndërsa ka ligjëruar në shumë universitete me renome ndërkombëtare në rajon, Evropë dhe Amerikë. Reka është profesor i së Drejtës Ndërkombëtare Publike dhe i së Drejtës së BE-së.



# Katër ministra dorëzojnë detyrën te Rozeta Hajdari

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

Prishtinë, 6 shkurt - Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Muzafer Shala, ua ka dorëzuar detyrën të enjten ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Rozeta Hajdari dhe ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Ministri Shala me këtë rast u ka uruar suksese në detyrat e reja të dy ministreve. "Sot zyrtarisht e dorëzuam detyrën, specifikë është që kjo ministri kalon në zhvillimin ekonomik dhe një pjesë në atë të arsimit. Shprehëm gatishmërinë që edhe në të ardhmen të bashkëpunojmë për të rinjtë e Kosovës", ka thënë ai.

Ministri Muzafer Shala tha se fusha e inovacionit dhe ndërmarrësisë është premtuese për të ardhmen, sidomos bizneset fillestare dhe shërbimet për kompanitë jashtë vendit. "Si Ministri e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë kemi përkrahur rreth 250 Start Up biznese dhe kompani të ndryshme, kemi themeluar Qendrat e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në Ferizaj, Prishtinë, Mitrovicë dhe disa të tjera janë në proces të themelimit. Kemi përkrahur dhe themeluar Qendrën Mulitifunksionale Inovative në Shtime, kemi filluar përkrahjen me pajisje të teknologjisë informative të kabineteve nëpër shkollat e mesme të Kosovës si dhe shumë projekte të tjera që do t'i shërbejnë zhvillimit ekonomik të vendit", ka theksuar ministri Muzafer Shala.

Ndërkaq ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjik, Rozeta Hajdari, ka thënë se do të koordinohen edhe me dikasteret e tjera qeveritare. "Sot morëm mandatin bashkë me ministren e Arsimit. Do t'i kemi punët në koordinim të përbashkët. Është shumë në interes të punojmë bashkë. Do të koordinohemi shumë afër si ministri me ministritë e tjera", ka deklaruar Hajdari.





Kurse ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Hikmete Bajrami, ka pohuar se janë për zbatimin e planit qeverisës për zvogëlimin e ministrive dhe ka premtuar koordinim në mes të këto dy ministrive. "Jemi këtu për t'i marrë detyrat nga Ministria e Inovacionit dhe jemi këtu për zbatimin e planit qeverisës për zvogëlimin e ministrive. Një nga pengesat që nuk kemi zhvillim të hovshëm është diskrepanca në mes të ministrive", ka theksuar ministrja Bajrami.

Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ishte themeluar më 9 shtator të vitit 2017. Po ashtu, ministri në largim i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, i ka dorëzuar të enjten detyrën ministres së re të Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Investimeve Strategjike, Ndërmarrsisë, Industrisë, Rozeta Hajdari, së cilës i ka uruar suksese dhe e ka njoftuar me të arriturat dhe sfidat.





Ministri në largim, Valdrin Lluka, e ka njoftuar ministren Hajdari për projektet që janë realizuar, për ato që janë në proces dhe ato që priten të fillojnë në fushën e teknologjisë, energjisë, ndërmarrjeve publike dhe minierave. Ai ia dorëzoi raportin e detajuar të punës, të cilën e ka bërë gjatë periudhës shtator 2017 dhe shkurt 2020.

Edhe ministri i deritashëm i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ia ka dorëzuar detyrën me planet dhe objektivat për vitin 2020 ministres së re Rozeta Hajdari. Me këtë rast, ish-ministri Shala e uroi ministren Hajdari për pozitën e re dhe më pas e njoftoi shkurtimisht për punën dhe projektet e përfunduara dhe ato në vazhdimësi.

Ndërkaq, ministrja Rozeta Hajdari ka shprehur gatishmërinë e saj për të bashkëpunuar me të gjithë për t'i zhvilluar fushat që janë në kuadër të kësaj ministrie, që do të ndikojnë në zhvillimin e gjithëmbarshëm të vendit.

Të enjten edhe ministri i deritashëm i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka dorëzuar detyrën te ministrja e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjik, Rozeta Hajdari.

# GAP-i: Qeveria Kurti do të kursejë 13 milionë euro në vitin e parë të mandatit

Prishtinë, 6 shkurt (ER) - Instituti GAP ka vlerësuar se me formatin e ri Qeveria e Kosovës që drejtohet nga Albin Kurti do të kursejë rreth 13 milionë euro për një mandat në krahasim me shpenzimet që bënte qeveria e drejtuar nga PAN-i. "Edhe pse koalicioni LV - LDK paraprakisht kishte planifikuar të kishte vetëm 12 ministri, një ditë para zyrtarizimit partitë bënë të ditur se kanë vendosur ta formojnë qeverinë me 15 ministri. Teksa një qeveri me 12 ministri vendit do t'ia kursente 15.5 milionë euro, një e tillë me 15 ia kursen vendit 13 milionë euro. Në infografikën e re është llogaritur se Qeveria Kurti do të ketë 33 zëvendësministra, për dallim nga PAN-i që kishte më shumë se 80. Këshilltarë të lartë të ministrave do të jenë 15 nga 21 sa ishin në qeverisjen e kaluar. Në 90 nga 126 ka rënë numri i këshilltarëve të ministravë", ka njoftuar GAP-i.

Më tutje, GAP-i ka theksuar se duke u bazuar në shpenzimet e ish-qeverisë, me formatin e zvogëluar, për një mandat Qeveria Kurti do të kursejë 10 milionë euro në paga, 1 milion në ushqime dhe rreth 1.5 milion të tjera në telefona mobilë, karburante e telefona fiks. "Bazuar në premtimet zgjedhore të LV-së dhe LDK-së, më 24 tetor 2019 Instituti GAP ka publikuar një infografikë e cila pasqyron kursimet qeveritare në rast se qeveria e re u përmbahet premtimeve për numrin e posteve ministrore. Qeveria e dalë nga zgjedhjet e 6 tetorit 2019 nuk iu përmbajt në tërësi premtimit. Sot Instituti GAP publikon infografikën e re lidhur me postet ministrore dhe ndryshimet nga qeveria e kaluar", ka njoftuar ky institut.



# Ekipet e MBPZhR-së në terren për vlerësimin e dëmeve në bujqësi

PRISHTINË, 6 SHKURT (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka dërguar në terren ekipin e vet, i cili, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Komunës së Pejës dhe të Istogut, do t'i shënojë dëmet e shkaktuara në sektorin e bujqësisë nga erërat e forta që kanë mbretëruar mbrëmjen e kaluar në këtë rajon. Me këtë rast, ministri i MBPZhR-së, Besian Mustafa, ka thënë se duke marrë parasysh gjendjen aktuale në terren, me ç'rast këto zona të vendit janë dëmtuar nga erërat e forta, ministria që ai drejton, përmes këtyre ekipeve, do t'i shënojë dëmet e krijuara nga kjo fatkeqësi natyrore. "Raportimet preliminare tregojnë për dëme kryesisht në serrat dhe stallat e fermerëve të këtij rajoni. Ekipet tona do t'i monitorojnë dhe vlerësojnë këto dëme dhe si ministri do t'i analizojmë mundësitë buxhetore, ligjore dhe operative për t'i përkrahur fermerët tanë drejt rikuperimit sa më shpejt", ka thënë ministri Mustafa.



# ATK-ja vetëm në janar mblodhi mbi 67 milionë euro

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 SHKURT - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se e ka nisur suksesshëm vitin 2020, pasi vetëm për muajin janar janë inkasuar 67.1 milionë euro të hyra që, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rritje për 14 për qind apo 8.2 milionë euro më shumë. Veç të hyrave tatimore, ATK-ja ka inkasuar edhe 17.7 milionë euro kontribute pensionale. "Administrata Tatimore e Kosovës këtë vit ka vendosur prioritete të shumta, realizimi i të cilave do të ndikojë në përmirësimin e proceseve të punës si dhe arritjen e projeksionit të të hyrave vjetore, por edhe zvogëlimin e stokut të borxheve. Për këtë qëllim tani janë marrë të gjitha veprimet te konsolidimi i mbledhjes së detyrueshme. Me qëllim të rritjes së rezultateve në mbledhjen e borxheve, është riorganizuar Departamenti i Mbledhjes së Borxheve në një qendër të vetme në Prishtinë, në kuadër të të cilit do të funksionojnë katër divizione, ku secili divizion do të jetë përgjegjës vetëm për një fazë të caktuar të trajtimit të borxheve", është thënë në njoftimin për media të ATK-së.
Sipas ATK-së, qëllimi i këtij reformimi është iniciuar duke pasur parasysh nivelin e lartë të borxheve të krijuara nga tatimpaguesit, ku përmes projektit të Konsolidimit të Mbledhjes së Borxheve, ATK-ja do të sigurojë procedura dhe qasje të re, në përmirësimin e procesit të trajtimit të borxhit në fazë të hershme, si dhe për ta zvogëluar stokun e madh të borxheve. "Reflektim të madh do të ketë edhe modernizimi i teknologjisë informative, ku në fund të muajit janar është finalizuar marrëveshja kontraktuale me konsorciumin, i cili do ta mundësojë digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve të punës në



Administratën Tatimore. Përmes sistemit të ri të teknologjisë informative, do të lehtësohet deklarimi dhe pagesa e tatimeve, si dhe do të mundësohen metoda elektronike shumëkanalëshe të komunikimit", është theksuar në njoftimin për media.
Më tej, në këtë njoftim është theksuar se "vizioni i ATK-së është të jemi të besueshëm dhe të respektuar, si dhe të jemi mirë të krahasueshëm me administratat udhëheqëse tatimore në Evropë".

# Qeveria Kurti, ndërmjet premtimeve, realiteteve dhe presioneve



Prof. Lisen BASHKURTI

Më 3 shkurt 2020 Kuvendi i Republikës së Kosovës votoi përbërjen dhe programin e Qeverisë së re me kryeministër Albin Kurtin. Qeveria Kurti doli pas zgjedhjeve të 6 tetorit 2019 dhe u votua pas një procesi të gjatë negociatash midis dy partnerëve politikë, LV-së dhe LDK-së. Opinioni vendas, mbarëshqiptar, rajonal dhe ndërkombëtar, e ka përcjellë me interesim të lartë këtë moment ndryshimi politik thelbësor në udhëheqjen e Kosovës. Kryeministri Kurti, përbërja e kabinetit të tij dhe programi i shpalosur në Kuvend, përbëjnë shpresa për të ardhmen e Kosovës. Por, që këto shpresa të bëhen realitet, Qeveria Kurti duhet t'i konsiderojë në mënyrë të balancuar premtimet, realitetet dhe presionet nga brenda dhe nga jashtë.

## 1. Midis establishmentit të vjetër dhe opozitës së re

Qeveria Kurti ka marrë drejtimin e Kosovës pas një periudhe të gjatë të qeverisjes nga PDK-ja dhe AAK-ja, të njohura brenda dhe jashtë Kosovës si forcat politike të krahut të luftës. Trashëgimia e kësaj qeverisje ka lënë problematika serioze sistemike dhe sektoriale në Kosovë. Sistemi politik në Kosovë, ekzekutivi, legjislativi dhe drejtësia janë mbarsur me mungesa të theksuara integriteti, profesionaliteti, pavarësie dhe mungesë kontrolli e balancash ndërmjet tyre. Korrupsioni, inkriminimi, padija, nepotizmi, politizimi i skajshëm vulgar reflektohen në gjithë organizimin e sistemit politik të vendit.

Establishmenti i vjetër e ka keqqeverisur Kosovën. Ato kanë çaluar në identifikimin e problemeve të Kosovës, në formulimin e politikave publike, në përgatitjen dhe adoptimin e strategjive dhe prioriteteve të shtrira në kohë dhe hapësirë, në legjislacion, në ndërtim institucionesh, në administrim kapacitetesh njerëzore, në menaxhimin e resurseve financiare, në implementimin e ligjeve, projekteve dhe politikave publike, në evoluimin e tyre në proces dhe në përmirësimet e vazhdueshme varësisht nga premtimet dhe problematikat e reja.

Establishmenti i vjetër i Kosovës ka konsumuar kohë, burime dhe financa me një efikasitet të ulët. Analiza kosto-benefit i establishmentit të vjetër në Kosovë kanë lënë shumë për të dëshiruar në sektorët e ekonomik, në aspektin social, në rritjen e varfërisë, papunësisë, dëshpërimit të rinisë e zhgënjimit të shtresës së mesme, në rënien e nivelit të arsimit, shëndetësisë, mjedisit dhe zhvillimit infrastrukturorë dhe urban.

Tanimë, establishmenti i vjetër ka kaluar ose po kalon në opozitë. Është herët për të treguar se çfarë opozitë do të bëjnë. Por, lidershipi dhe përbërja e tyre si dhe performanca e parë parlamentare lënë për të dëshiruar. Ndihet një frymë kritizere e sëmurë dhe plot paragjykime, duket një sjellje e rëndomtë dhe e ashpër që paralajmëron marrëdhënie të polarizuara dhe konfrontuese mazhorancë-opozitë.

Pra, sfida e parë që do të duhet të përballet Qeveria - Kurti është, njëherësh, eliminimi i pasojave të qeverisjes së establishmentit të vjetër dhe menaxhimi i sjelljes të tyre politike në rolin e opozitës së re. Duke pasur parasysh se 'krahu i luftës' PDK, AAK vijnë pas një përvoje të gjatë qeverisëse, ndërkohë që LV-ja është pa një përvojë të tillë, merret me mend sesa sfiduese do të jetë marrëdhënia politike Qeveri-opozitë.

Marrëdhënia mazhorancë-opozitë varet jo vetëm nga sjellja e establishmentit të vjetër në rolin e opozitës së re, por në masë të konsiderueshme edhe nga qasja e mazhorancës ndaj kësaj opozite. Kryeministri Kurti, koalicioni LV-LDK duhet të mbajnë në mend se ndëshkimin për qeverisjen dhe establishmetin e vjetër e bënë qytetarët e Kosovës dhe nuk ka vend që ta ribëjë edhe qeveria e re. Kurti dhe mazhoranca që ai drejton duhet të mbajnë në konsideratë se ish-luftëtarët e UÇK-së vlerësohen si heronj në popull dhe do të kenë gjithherë mbështetje popullore. Kurti, koalicioni qeveritar LV-LDK është e domosdoshme t'i njohin dhe respektojnë ndjenjat dhe traditat patriotike dhe kombëtare, të jenë të vetëpërmbajtur, të qetë, të ekulibruar, me qëllim që ta shmangin polarilizimin dhe konfrontimin politik dhe ta ruajnë e ta mbajnë me kujdes situatën në vend.

## 2. Pritshmëritë, midis premtimeve dhe realiteteve

Qeveria Kurti, ose ndryshe koalicioni qeveritar LV-LDK, u votuan nga shumica e qytetarëve të Kosovës, nisur nga nevojat e thella të shtetit dhe të mbarë shoqërisë kosovare. Ishte padyshim një votë për një kthesë të thellë, për një ndryshim radikal, për një përmirësim rrënjësor, për një revolucion qeverisës, për një establishmnet tërësisht të ri, modern, të arsimuar dhe me integritet, për një të ardhme të mirë, të lirë, demokratike dhe me prosperitet.

Vota e koalicionit LV-LDK është një votë cilësore dhe duhet të llogaritet si e tillë. E them këtë, sepse kam dëgjuar, lexuar e parë komente të establishmentit të vjetër ose opozitës së re në Kosovë, që flasin për zgjedhjet e 6 tetorit 2019 përllogarisin vetëm numrat, pra e konsiderojnë si një votë sasiore. Është padyshim qasje e pasaktë, e padrejtë, në mos jo dashamirëse.

Nëse establishmenti i vjetër ose opozita e re në Kosovë nuk do ta lexojnë votën e 6 tetorit 2019 si një votë cilësore, atëherë ata kanë pak ose aspak gjasa që të reflektojnë për gabimet e së kaluarës, për reformimin e tyre të thellë vertikal dhe horizontal, për ndërtimin e strategjisë së re në opozitë dhe për të pasur një qasje kooperuese dhe kompetitive në raportet mazhorancë-opozitë. Establishmenti i vjetër mund të shndërrohet në opozitë të re vetëm nëse arrin ta kuptojë

## Në Universitetin "Ukshin Hoti" u bë përurimi i kabinetit të informatikës

Prizren, 6 shkurt (ER) - Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren të enjten është bërë përurimi i kabinetit të informatikës dhe sallës së mbledhjeve, të financuar nga Këshilli Turk (ushtria turke që shërben në kuadër të KFOR-it) në Prizren.

Prerjen e shiritit e kanë bërë rektori prof. asoc. dr. Ismet Temaj, ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çaaren Sakar, komandanti i njësisë së Këshillit Turk - kolonel Numan Bash dhe kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka.

Rektori i Universitetit "Ukshin Hoti' në Prizren, Ismet Temaj, në fjalën e tij me këtë rast, ka falënderuar KFOR-in turk dhe Republikën e Turqisë për këtë donacion dhënë universitetit, por edhe për mbështetjen e vazhdueshme që kanë dhënë në të kaluarën. Ai ka theksuar se universiteti që nga themelimi ka shënuar shumë suksese dhe se po ecën me hapa të sigurt drejt të ardhmes.

Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, Halil Kukaj, në fjalën e tij ka thekuar se kabineti i informatikës do ta mundësojë zbatimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie dhe mësimnxënies dhe, përpos mbajtjeve të ligjëratave, edhe mbajtjen e provimeve online, duke arritur kështu trendin global të digjitalizimit.

Ambasadori i Turqisë në Kosovë, Çaaren Sakar, ka theksuar se i vjen shumë mirë që në këtë universitet mësimi organizohet edhe në gjuhën turke, duke shprehur urimet më të mira për studentët dhe stafin e këtij universiteti.



thellë se ata u ndëshkuan të kalojnë në opozitë nga qytetarët, nga pakënaqësitë dhe kërkesat e tyre dhe jo thjesht nga LV-LDK.

Vota cilësore e 6 tetorit 2019 për koalicionin LV-LDK është për qeverisje të mirë, legjitime, transparente, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse. Është votë për një administratë publike qendrore dhe vendore të vogël, ekonomike, profesionale të bazuar në meritë, me integritet, me përkushtim, me qytetari dhe patriotizëm.

Vota cilësore për koalicionin LV-LDK është thirrje qytetare për shtetin e së drejtës, për sundimin e ligjit, për luftën kundër korrupsionit dhe krimit, për respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të pakicave, për zhvillim ekonomik e social, për më shumë punë e prosperitet, për më shumë arsim, kulturë dhe shkencë, për më shumë shëndetësi, sporte e mjedis, për më shumë kohezion social-ekonomik, urban dhe infrastrukturor.

Vota cilësore qytetare e 6 tetorit është për një ndryshim të thellë të cilësisë së jetës dhe për një qartësim të perspektivës për qytetarët e Kosovës. Këto janë pritshmëri shumë të larta, të nxitura nga pakënaqësitë e thella të krijuara nga qeverisjet e këqija për një kohë të gjatë në Kosovë dhe nga ngjallja e shpresave të reja për një qeverisje të re dhe lidership të ri. Suksesi i Qeverisë Kurti dhe koalicionit LV-LDK do të varet nga trajektorja qeverisëse, nga pakënaqësitë drejt përmbushjes së shpresave.

Zgjedhësit e pakënaqur, idealistët dhe ëndërrimtarët e 6 tetorit 2019 kanë varur shpresat e tyre të mëdha te Qeveria Kurti. Ato presin ndjekjen e një linje të qartë dhe të vendosur anti-establishment që Kurti ia ka premtuar. Qytetarët presin prej Qeverisë Kurti luftë pa kompromis kundër nepotizmit, tarafeve politike, krahinariste, familjare e miqësore, kundër monopoleve dhe abuzimeve të çfarëdolloj me pushtetin. Opinioni publik ngulitur në popullin e Kosovës për Albinin, si i pakorruptueshëm, i drejtë, i ditur, i aftë dhe i vendosur, është sfidë jashtëzakonisht serioze personale për kryeministrin Kurti. Është koha që ai t'i dëshmojë këto cilësi, t'i qëndrojë me seriozitet reputacionit të tij dhe të ndjekë pa mëdyshje linjën që e ka kristalizuar në vitet e opozitës dhe për të cilën u zgjodh në krye të qeverisë.

### 3. Dilemat midis premtimeve dhe presionit ndërkombëtar

Qeveria Kurti dhe koalicioni LV-LDK do të përballen paralelisht me sfidat e brendshme, edhe me sfidat ndërkombëtare. Në agjendën ndërkombëtare qeveria Kurti ka këto prioritete: fuqizimin dhe dinamizimin e marrëdhënieve strategjike me ShBA-në, NATO-n, BE-në dhe Shqipërinë; normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë mbi baza reciprociteti, përmes dialogut dhe negociatave drejt një marrëveshje të negociueshme kompromisi Kosovë - Serbi; zgjerimin e njohjeve ndërkombëtare dhe integrimin në organizata rajonale dhe universale; integrimin në NATO dhe BE. Këto prioritete janë tërësi kapilare e strategjisë së Qeverisë Kurti në politikën e jashtme.

Ndër më sfiduesit është padyshim rifillimi i negociatave për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi për arritjen e një marrëveshje të negociuar kompromisi midis palëve. Për shkaqe që dihen dialogu Prishtinë - Beograd është bllokuar. Ndërkohë është riaktivizuar dukshëm diplomacia e ShBA-së dhe e BE-së për ta rifilluar procesin e negociatave dypalëshe me ndërmjetësim ndërkombëtar, kryesisht ShBA dhe BE. Qeveria Kurti po vihet kështu përballë një presioni në rritje për agjendat e ndërprera ndërkombëtare.

Kurti, LV-ja dhe LDK-ja kanë qenë aktivë, kritikë dhe alternativë në qasjen e qeverive të mëparshme të Kosovës ndaj dialogut me Serbinë. Kurti dhe LV-ja kanë mbështetur masat e qeverisë Haradinaj ndaj tregtisë me Serbinë. LV-ja dhe LDK-ja së bashku kanë kundërshtuar fort skenarët për 'korrigjim kufijsh', 'ndryshim kufijsh', 'shkëmbim territoresh' duke mbrojtur integritetin dhe tërësinë territoriale të Kosovës.

Për Kurtin parimi themelor për rifillimin dhe arritjen e marrëveshjes së negociueshme Prishtinë-Beograd është parimi i reciprocitetit midis dy vendeve. Duhet theksuar se qasja ndaj dialogut me Serbinë dhe skenarëve të diskutuar për marrëveshjen e kompromisit midis Prishtinës dhe Beogradit kanë qenë një vijë ndarëse e thellë brenda politikës kosovare.

Qeverisë Kurti i bie një barrë e rëndë për ta krijuar mjedisin politik për t'i përgatitur qytetarët e Kosovës dhe gjithë spektrin politik të vendit për rifillimin e negociatave me Serbinë përmes hartimit dhe adoptimit të strategjisë për arritjen e marrëveshjes së negociuar të kompromisit midis palëve. Qeverisë Kurti i bie pesha historike të sigurojë mbështetje gjithëpërfshirëse, popullore, politike dhe institucionale brenda Kosovës. Polarizimin e derisotëm të politikës Kosovare për qasjen ndaj zgjidhjes me Serbinë, Qeveria Kurti duhet ta shndërrojë në mirëkuptim, bashkëpunim, kompromis, konsensus dhe gjithëpërfshirje midis gjithë aktorëve dhe faktorëve politikë, institucionalë dhe qytetarë të Kosovës. Për këtë Kurtit i duhet punë e madhe përgatitore.

Në procesin e përgatitjes së klimës dhe strategjisë negociuese për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, Qeveria Kurti ka nisur të përballet që tani me presion ndërkombëtar në rritje.

Përballimi dhe adresimi i këtij presioni, ngado që të vijë, duhet të bëhet duke mos cenuar linjën e deritanishme të LV-LDK-së dhe të Kurtit personalisht në qasjen ndaj Serbisë, parimeve të negociatave me të dhe të strategjisë së reciprocitetit për arritjen e marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi.

Kurti, LV-LDK-ja janë votuar për linjën e tyre në politikën e jashtme, në qasjen ndaj Serbisë dhe në arritjen e marrëveshjes së kompromisit mbi parimin e reciprocitetit. Sa kohë Qeveria Kurti, LV-LDK-ja do t'i qëndrojnë linjës së tyre në qasjen ndaj Serbisë ato do të gëzojnë mbështetje të madhe dhe të fuqishme të brendshme, çka garanton suksesin e procesit dhe të Qeverisë Kurti. Çdo cenim i linjës së Kurtit, LV-LDK në qasjen ndaj Serbisë, do ta dobësonte mbështetjen e saj të brendshme dhe do të sillte dështim të pashmangshëm.

Normalizimi i marrëdhënieve Kosovë - Serbi me ndërmjetësim ndërkombëtar të ShBA-BE-së nuk varet vetëm nga Kosova. Serbia, nga ana e saj, ka shumë rrugë për të bërë në ndryshimin e qasjes së saj ndaj Kosovës. Ka edhe faktorë të tjerë ndërkombëtarë ndërmjetësues me rëndësi jetike siç janë ShBA-ja dhe BE-ja. Të gjithë duan kohën e vet për t'iu afruar zgjidhjes së negociuar të kompromisit. Pra, do të kemi një kompromis ndërkombëtar, jo thjesht dy palësh.

Arritja e këtij kompromisi ndërkombëtar kërkon që të shpejtohemi, por jo të nxitohemi. Zgjidhja e shpejtuar sjell paqe e stabilitet për të gjithë. Zgjidhja e nxituar sjell zgjidhje të parakohshme, të pasakta, të gabuara dhe të padrejta, çka rrezikon paqen dhe stabilitetin për të gjithë.

Ka disa faktorë politiko-diplomatikë ndërkombëtarë, midis tyre edhe dashamirës të Kosovës, që mund të kërkojnë me nxitim arritjen e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi për arsye të ndryshme e që nuk lidhen domosdoshmërisht direkt me këtë çështje. Qeveria Kurti duhet t'i njohë dhe t'i përballojë me qetësi dhe argumente presionet ndërkombëtare për marrëveshje të nxituar Kosovë - Serbi, duke pasur parasysh se një pjesë e këtyre presioneve dhe nxitimeve vijnë ngandonjëherë të diktuara nga situatat politike të brendshme që kalon çdo aktor ndërkombëtar apo nga konjukturat gjeopolitike ndërkombëtare. Pra, nuk ka vend për nxitim. Kosova ka jetuar njëqind vjet nën robërinë serbe dhe më në fund ka triumfuar. Në kushtet e lirisë, pavarësisë e sovranitetit të saj, Kosova mund të jetojë edhe një mijë vjet të tjera pa Serbinë. Zhvillimet politike në marrëdhëniet ndërkombëtare lëvizin shumë më ngadalë sesa zhvillimet politike të brendshme. Kjo duhet të mbahet mirë parasysh nga Qeveria Kurti.

## Inspektohet gjendja e rrugëve në qytetin e Mitrovicës

**Mitrovicë, 6 shkurt (ER)** - Situata e përgjithshme në rrugët e qytetit të Mitrovicës, pas reshjeve të borës, është përmirësuar dukshëm. Shumica e rrugëve janë të kalueshme, ndërkohë që ka intervenime të pandërprera të kompanive për mirëmbajtjen e rrugëve në zonën e Shalës së Bajgores për shkak të telasheve që paraqiten si pasojë e erërave të forta që mbretërojnë atje herë pas here.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, ka inspektuar mbrëmë gjatë gjithë natës pastrimin e borës nga rrugët, e sot ka dalë prapë në terren për ta parë nga afër gjendjen e rrugëve, pas reshjeve të fundit të borës në qytetin e Mitrovicës. "Ndonëse në qytet të gjitha rrugët janë të pastruara, në viset rurale ende kemi borë, kështu që këto ditë kemi pasur intervenime më të shpeshta, sidomos në rajonin e Shalës së Bajgores si pasojë e fërfëllizës që mbretëron atje. Por, falë punës së kompanive të kontraktuara, shumica e rrugëve janë të kalueshme", ka thënë drejtori Muja. Po ashtu, drejtori Muja ka kërkuar nga kompanitë e kontraktuara që të jenë sa më aktive dhe të gatshme që t'u dalin në ndihmë qytetarëve, sidomos në ato zona ku gjendja është më e vështirë.





## FBI: Kina, rreziku më i madh

UASHINGTON, 6 SHKURT - FBI-ja shpalli të enjten Kinën si kërcënimin më të madh për forcat e zbatimit të ligjit në Shtetet e Bashkuara. Drejtori i agjencisë Christopher Wray tha se Pekini po kërkon të vjedhë teknologji amerikane duke përdorur çdo mjet të nevojshëm. Ai shtoi se 56 zyrat rajonale të agjencisë kanë hapur rreth 1 000 hetime lidhur me përpjekjet nga ana e Kinës për të vjedhur teknologji. Shefi i kundërzbulimit në FBI, John Brown, tha se agjencia ka arrestuar 24 persona në 2019-n lidhur me raste ku përfshihej Kina dhe gjatë këtij viti janë arrestuar 19 persona të tjerë. Gjatë një konference në Uashington DC në Qendrën për Studimeve Strategjike e Ndërkombëtare (CSIS), Brown tha se FBI-ja besonte "se asnjë vend nuk paraqet një kërcënim më të madh sesa Kina komuniste". Wray tha se kërcënimi duhej të përballej me veprime nga gjithë Qeveria amerikane. "FBI-ja po kryen 1 000 hetime që kanë të bëjnë me përpjekjet e mbetura në tentativë të Kinës për të vjedhur teknologji amerikane në pothuajse çdo sektor të industrisë", tha ai. Wray shtoi se Kina po shfrytëzon në mënyrë agresive hapjen akademike të ShBA-së për të vjedhur teknologji, duke përdorur bashkëpunëtorë në kampe dhe duke krijuar institute në komplekset amerikane. Drejtori i Kundërzbulimit Kombëtar dhe Qendrës së Sigurisë, William Evanina, tha në konferencë se Kina kishte si përparësi të veçantë vjedhjen e teknologjisë së avionëve amerikanë dhe makinave elektrike.

# Trump: Demokratët, të pandershëm dhe të korruptuar

Presidenti amerikan Donald Trump, në ceremoninë e përvitshme Mëngjesi i Lutjeve, i quajti "të pandershëm dhe të korruptuar" demokratët të cilët u përpoqën ta shkarkojnë, ndërkohë që akuzoi disa prej "armiqve" të vet politikë se e përdorin fenë për t'i justifikuar veprimet e tyre të gabuara




UASHINGTON, 6 SHKURT - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, i cili përballet me një fushatë të ashpër për t'u rizgjedhur, i quajti "të pandershëm dhe të korruptuar" demokratët të cilët u përpoqën ta shkarkojnë, ndërkohë që akuzoi disa prej "armiqve" të vet politikë se e përdorin fenë për t'i justifikuar veprimet e tyre të gabuara.
Presidenti i bëri komentet në ceremoninë e përvitshme Mëngjesi i Lutjeve në Uashington. Këto janë komentet e tij pasi gjyqi për shkarkimin e tij në Senatin e kontrolluar nga republikanët e shpalli të pafajshëm. "Siç e dinë të gjithë, tha presidenti Trump, familja ime, vendi ynë i shkëlqyer dhe presidenti juaj u vu në një provë të tmerrshme nga disa njerëz shumë të pandershëm dhe të korruptuar". "Ata bënë gjithçka ishte e mundur për të na shkatërruar dhe duke vepruar kështu e dëmtuan shumë vendin tonë", tha presidenti Trump.
Me votat kryesisht në linja partiake, të mërkurën Senati e liroi presidentin Trump nga akuzat për shpërdorim pushteti dhe pengim të Kongresit, duke votuar kundër shkarkimit të tij. Votimi u zhvillua veç e veç për të dyja akuzat.
Për akuzën e parë - abuzim të pushtetit - 52 senatorë votuan për shfajësimin e presidentit, ndërsa 48 për fajësimin e tij.
Ndërkaq, për akuzën e dytë - pengim të punës së Kongresit - 53 vota ishin për shfajësim, 47 për fajësim.
"Donald Trump, presidenti i Shteteve të Bashkuara, nuk është gjetur fajtor", tha pas votimit gjykatësi John Roberts, i cili kryesoi gjykimin.
Për shkarkimin e presidentit nga detyra do të duheshin dy të tretat e votave të Senatit prej 100 anëtarësh.
Nga Partia Republikane vetëm Mitt Romney votoi për fajësimin e tij për abuzim të pushtetit.
Akuzat kundër Trumpit janë ngritur në muajin dhjetor nga Dhoma e Përfaqësuesve e ShBA-së, e udhëhequr nga demokratët.
Në janar çështja ka kaluar në Senat, ku akuzuesit dhe ekipi mbrojtës i presidentit kanë paraqitur argumentet e tyre.
Trump është presidenti i tretë në historinë e Shteteve të Bashkuara që është përballur me mundësinë e fajësimit nga Senati dhe rrjedhimisht shkarkimin nga detyra.
Sipas akuzave të ngritura, Trump i ka bërë presion Ukrainës për të zbuluar informacione të dëmshme për rivalin e tij politik, Joe Biden.
Presidenti Trump po kandidon për zgjedhjet që do të mbahen më 3 nëntor dhe gëzon mbështetje të fortë nga të krishterët ungjillorë dhe katolikët konservatorë. Pa përmendur emra, ai kritikoi disa nga kundërshtarët e tij se përdorën besimin fetar për t'i justifikuar veprimet e tyre gjatë procesit në Senat.
Senatori republikan Mitt Romney, i cili është mormon, përmendi besimin e tij fetar kur votoi për shkarkimin e presidentit Trump në Senat, nën akuzën për shpërdorim pushteti. Pas votimit në Senat, demokratët duket se janë të pasigurt për hapat e tyre të ardhshëm në hetimet kundër presidentit.

## Ankaraja i kërkon Moskës t'i ndalë sulmet në Idlib

ANKARA, 6 SHKURT - Turqia i kërkoi Moskës që t'iu japë fund menjëherë sulmeve të forcave të Qeverisë siriane në rajonin veriperëndimor të Idlibit. Duke folur përpara gazetarëve të enjten në kryeqytetin e Azerbajxhanit Baku, ministri i Jashtëm Mevlut Cavusoglu shtoi se Ankaraja duhet të punojë me Moskën për të zgjidhur problemet në Idlib, fortesa e fundit e rebelëve në Siri.
Pas një sulmi të forcave siriane gjatë të cilit u vranë tetë ushtarakë turq në Idlib më 3 shkurt, presidenti turk Rexhep Tajip Erdogan ka kërcënuar t'i sprapsë forcat qeveritare siriane, nëse nuk tërhiqen nga rajoni deri në fund të muajit.
Cavusoglu tha gjithashtu se një delegacion rus do të vizitonte Turqinë për të diskutuar rreth situatës në Idlib dhe se nëse do të ishte e nevojshme presidenti Erdogan mund të takohej me presidentin rus Vladimir Putin.
Ndërkohë Ministria e Jashtme ruse tha të enjten se "specialistë ushtarakë" rusë e turq u vranë nga militantët që kishin organizuar më shumë se 1.000 sulme në dy javët e fundit të janarit në zonën e Idlibit.
"Kohët e fundit ka pasur një rritje të rrezikshme të tensionit dhe një rritje të dhunës në Idlib", thuhej në një njoftim të ministrisë në faqen e saj në internet.
Rusia vazhdon të bashkëpunojë ngushtë me Turqinë dhe Iranin në terren në Siri, thuhet gjithashtu në deklaratë.
Turqia dhe Rusia, të cilat mbështesin palët kundërshtare në konfliktin në Siri, kanë rënë dakord të punojnë për shtensionimin e situatës në Idlib dhe krijimin e një zone të çmilitarizuar.



SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. DEGA KOSOVË**

# NJOFTIM PËR ZHVENDOSJE TË ZYRËS

*Të nderuar klientë dhe palë të interesuara,*
Ju njoftojmë se Zyra Qendrore e kompanisë së sigurimeve Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Dega Kosovë do të zhvendoset në adresën e re, që është:
**• Aktash, Rr. Edmond Hoxha nr. 27 (afër udhëkryqit tek menza e studentëve), Prishtinë 10000, Republika e Kosovës**

Data e planifikuar/propozuar dhe për zhvendosjen e zyrës qendrore është 23.12.2019.
Ne do të vazhdojmë të jemi në dispozicionin tuaj për t'ju ofruar shërbimet e kompanisë tonë të sigurimeve në adresën e re të lartshënuar të Zyrës Qendrore.
**Ju faleminderit për mirëkuptimin dhe ju mirëpresim në zyrat e reja!**

# NOTICE FOR OFFICE TRANSFER

*Dear clients and interested parties,*
We inform you that the Head Office of insurance company Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Kosovo Branch will move to the new address, that is:
**• Aktash, Edmond Hoxha Str. No. 27 (near the crossroads of the student mess canteen), Prishtina 10000, Republic of Kosova**

The planned/proposed date for the Head Office transfer is 23.12.2019.
We will continue to be at your disposal to offer our insurance company's services at the above new Head Office address.
**Thank you for your understanding and welcome to the new offices!**

# OBAVIJEST O ZAMJENI KANCELARIJE

*Dragi klijenti i zainteresovane strane,*
Obaveštavamo vas da će glavno sedište osiguravajucćeg društva Sigma Interalbanian Vienna Insurance Group Sh.A. Filijala Kosova preseliti na novu adresu, a to je:
**• Aktash, Ul. Edmond Hoxha br. 27 (blizu raskrsnice studentske menze), Priština 10000, Republika Kosova**

Planirani/predložni datum preseljenja kancelarije na novu adresu glavnog sedišta je 23.12.2019.
Me čemo i dalje biti na vašem raspolaganju da vam pružimo usluge našeg osiguravajucćeg društva na gore navedenu novu adresu glavne







**SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A. - DEGA KOSOVË**
Qyteza Pejton, Rr. Ukshin Hoti Nr.13, Prishtinë, Republika e Kosovës
**Tel.+381 38 246 301, Fax. +381 38 246 302 www.sigma-ks.net info@sigma-ks.net**




# Simbolika hyjnore e varrit të Skënderbeut

## Novela "Raporti i fshehtë" e Kadaresë

Nga Ndue UKAJ

Njeriut gjithmonë i duhet e kaluara dhe një identitet mbi të cilin mund të qëndrojë, si pikënisje për të gjetur kuptimin dhe kozmogoninë e vet. Po ashtu, shkrimtarit i duhet një pikënisje për të ndërtuar veprën e vet letrare. Ismail Kadareja këtë hapësirë letrare, veç të tjerash, e ka kërkuar në histori, te simbolikat e veçanta, te heronjtë, atje ku imagjinata shtegton nëpër mundësitë dhe pamundësitë e jetës e të vdekjes dhe ku betejat janë të pamëshirshme, të ashpra, për të gjetur kuptime dhe moskuptime nëpërmes gjuhës së artit dhe mundësive të pafundme që ka ai, me ç'gjë ndikon pazëvendësueshëm në formimin e të vërtetave njerëzore.

Për Historizmin e Ri, një lëvizje letrare e viteve '80 që analizon raportet e letërsisë me pushtetin dhe politikën në artefaktet letrare, tekstet letrare kanë një funksion specifik përbrenda rrjetit të raporteve ndërmjet letërsisë dhe historisë. Kjo lëvizje letrare ka nxitur një kthesë të rëndësishme në mendimin letrar, duke u nisur nga ideja humane se letërsia mund t'i mësojë qeniet njerëzore me leksione morale dhe sjellje civile, pohon studiuesi John Brannigan. Në përkim me këtë, historianët e rinj mendojnë se letërsia dhe historia janë të pandashme.

Prandaj në studimet letrare të viteve të fundit është rritur interesi për t'i hulumtuar mënyrat sesi letërsia reflekton, formon dhe përfaqëson historinë dhe identitetin. Një shembull tipik në letërsinë shqipe për t'i provuar këto raporte, si në planin teorik po ashtu në atë praktik, është vepra letrare e Kadaresë, e cila ka lidhje të pashkëputshme dhe organike me historinë, kombëtare dhe universale, në planin tematik dhe në atë ligjërimor e estetik. Autori ka shprehur interes për t'i kthyer temat historike në tema letrare, rrjedhimisht, për të rindërtuar filozofinë e vet për historinë, në domenin e artefakteve letrare, si dhe për të dhënë leksione morale, të dobishme në kohë dhe kontekste të tjera. Historia dhe letërsia në veprën e Kadaresë bartin kuptime të shumëfishta, meqë aty kryqëzohen domethënie letrare e politike që lidhen edhe me semiosferën e marrëdhënieve të pushtetit me njeriun shqiptar të kohës së autorit. Këtë element e kanë vërejtur edhe njohësit e veprës së tij. Historia, si refleksion dhe dokumentaritet i provuar historik te vepra e tij, shfaqet dhe përçohet si kujtesë dhe shpalim artistik. E argumentet artistike, që janë po ashtu historike, autori i përdor si leksione morale për t'i harmanizuar sjelljet njerëzore, pra të lexuesve, dhe njëkohësisht për të treguar se ç'pëson njeriu kur i mohohet gjëja më e shtrenjtë, liria, ose kur ai vetë e mohon të kaluarën. Identiteti i letërsisë së Kadaresë, si tematikë dhe si filozofi, është formësuar mbi themelet kombëtare dhe kulturore që i ka vënë heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti, ndërkaq transfigurimi dhe transmetimi i këtij identiteti në letërsi është bartur te shumë vepra të tijat, si mall dhe ideal letrar, gjë që ka bërë ta "konsakrojë Kadarenë në rolin e intepretit të thellë të qytetërimit letrar shqiptar" (Matteo Mandalà). Dhe për të pasqyruar këtë qytetërim, nuk ka një figurë më të devotshme dhe më të plotë sesa Gjergj Kastrioti.

Skënderbeu i Kadaresë përshkruhet me devocion të plotë në shumë vepra letrare, por edhe në ato eseistike, siç ka bërë te libri monumental i identitetit dhe kulturës shqiptare Mosmarrëveshja – Shqipëria përballë vetvetes.

Skënderbeu i letërsisë së Kadaresë nuk është heroi i zakonshëm historik, ndërsa figura e tij nuk është sporadike, por e përshkon veprën e tij si frymë dhe ide, në poezi dhe në prozë, që nga krijimet e hershme deri tek ato të fundit. Nga historia, autori e ka nxjerrë heroin në hapësirat e imagjinatës, duke bërë zhvendosje kulturore, simbolike, zhvendosje këto që janë estetike dhe kështu atij i ka dhënë përmasa të jashtëzakonshme, të pakrahasueshme me ndonjë hero tjetër. Duke e njohur këtë shtrije, njohës të shumtë të veprës së Kadaresë, me të drejtë, kanë shkruar se vepra e tij është ndërgjegjja e popullit të tij, ku paraqitet identiteti shqiptar me të gjitha tiparet dhe karakteristikat që e shquajnë atë.

Kadareja në shumë tekste letrare ka rrëfyer për historinë, duke bartur në shkrimin fiktiv personazhe, ngjarje apo filozofinë e historisë. Nëpërmes këtij modeli shkrimor ai ka stigmatizuar totalitarizmin e ndonjëherë ka luftuar harresën dhe ua ka dhënë krah lexuesve të tij të topitur në rrëmuja e kriza kombëtare.

Në prozën Raporti i fshehtë, botuar më 2008, Kadareja s'e përdor alegorinë, aluzionet, për të shprehur idetë kulturore dhe politike, apo për të evokuar historinë, por në mënyrë krejt eksplicite, të sinqertë, nëpërmes simboleve, i flet lexuesit për figurën madhore të heroit kombëtar, Gjergj Kastriotit, arketipin e letërsisë shqipe të cilin e paraqet si domosdoshmëri kombëtare. Në këtë prozë autori e rikthen lexuesin në kohën e Perandorisë Osmane, te keshtjellat shqiptare, tek ato fortifikata shpirtërore që e shënjuan Motin e Madh, në Krujë, Lezhë, te varri i Gjergj Kastriotit, pra në Shqipërinë paskastriotiane që, në fakt, është derivim kastriotian. Autori këtë ngjarje letrare dhe historike e rindërton në bazë të imagjinatës së vet dhe jo të elementeve biografike, ndonëse rreth varrit të Skënderbeut ka tregime të shumta, popullore dhe të shkruara. Në novelën Raporti i fshehtë artistikja dhe historikja thyhen, ndeshen, e plotësojnë njëra-tjetrën, por kurrë s'e dëmtojnë njëra-tjetrën. Kështu që figura letrare është historike dhe letrare. Gjergji është shtrirja kohore e shqiptarëve në botë, nderi dhe tempulli ku ata gjejnë prehje. Heroi admirohet, është arketip dhe prototip për të ndërtuar narrativen kombëtare dhe kulturore, madje duke u bërë Krishti i shqiptarisë, siç del te ky tregimi i shkëlqyeshëm i Raporti i fshehtë, meqë varri i tij vihet krahas varrit të Jezu Krishtit, themeluesit të krishterimit.
Duke rrëfyer historinë e kësaj periudhe që zhvillohet në Shqipërinë Veriore, me figurë qendrore Kastriotin shembullor që është arketip i shtresuar në letërsinë shqipe që nga Barleti e këndej dhe rreth të cilit vërtiten personazhet e tjerë dhe perandoria e tërë, Kadareja e ka rikthyer fuqishëm frymën kastriotiane në art, duke e paraqitur si domosdoshmëri kombëtare. Vepra letrare në vete ka dy botë që ndeshen, jo me armë si dikur, kur Kastrioti ishte gjallë, por me varrin dhe eshtrat e tij, pra me fantazmën dhe kujtesën e tij. Aty janë pala turke dhe ajo shqiptare që përplasen rreth varrit të tij. E para, është e pajisur me të gjitha mundësitë që ia jep pushteti: dhunën, frikën, ndëshkimin, financat; e dyta, s'i ka asnjërën nga ato, por ka diçka më të çmueshme, lavdinë historike, figurën zëmadhe të Gjergj Kastriotit, shpirtin e tij që ia prish gjumin perandorisë. E kjo palë shfaqet e përkorë, moralisht e pathyeshme e ngadhënjimtare, dhe rri stoike përballë pushtetit të Tuz efendiut që, në raport me figurën e heroit kombëtar, del i turpëruar dhe qesharak. Lexuesi, për të kuptuar përmasën dhe dimensionin tejkohor të kësaj proze, duhet ta lexojë atë përmes një qasjeje interaktive me Biblën dhe diskursin biblik, sepse, në esencë, si filozofi shkrimi kjo prozë shpjegohet me episodet e vdekjes dhe ngjalljes së Krishtit, ku mbështetet filozofia e krishterimit dhe mbi ç'bazë autori e ndërton këtë rrëfim imagjinar dhe filozofinë e tekstit. Pra, autori nëpërmes simboleve letrare e ndërton tekstin dhe tejkohësinë e tij, në përkim me mësimin biblik rreth varrit të Krishtit, përkatësisht mungesës së tij, episode këto të cilat, siç tregon Bibla, lidhen me ngjalljen dhe shenjtërinë e tij, pra me qenësinë e tij hyjnore. Në këto elemente, të cilat autori i përdor vetëdijshëm, qëndron filozofia dhe esenca semantike e etike e kësaj proze.

### Gjergj Kastrioti ose Krishti shqiptar

Në këtë prozë Kastrioti është i vdekur, por ai rikthehet si frymë tejkohore, si shpirt, dhe krejt novela lidhet me të, me përmasën dhe shtrirjen e figurës së tij nëpër fusha, keshtjella, te zbrazëtia e varrit, tek ëndrrat e prishura të perandorisë, te meshtari. Pra, ai është gjithkund dhe askund, kësisoj merr trajtë metafizike, hyjnore. Për shqiptarët ai është i shenjtë, ashtu siç është Jezu Krishti për të krishterët, të cilët besojnë pikërisht te mungesa e varrit të tij. Ndërkaq për turqit është makth, fantazmë, që sjell lemeri, trishtim, frikë dhe turpërim.
Narratori i kësaj proze është një zë tjetër, narrator që nuk shfaqet në tekst si karakter, por i aftë për t'i zbuluar mendimet dhe motivet e një ose më shumë karaktereve të tjerë. Ai flet për palën turke dhe shqiptare duke treguar motivet dhe idetë që kanë të dyja për heroin tonë kombëtar.
Që në hyrje të tekstit narratori i flet lexuesit për një vërshim zyrtarësh nga kryeqyteti, në Tiranë, dhe sidomos në rrugën e Veriut që të shpie te Gjergj Kastrioti, te keshtjella e tij në Krujë, ku ato ditë qe kthyer mbrapsht Sangjakbeu i Shkupit i cili kishte kërkuar të hynte në keshtjellë dhe aty, në shtratin e Donikë dhe Gjergj Kastriotit, të bënte dashuri me princeshën e tij moldave dhe ku dikush ëndërronte të mbeste shtatzënë.
Ndryshe nga Sangjakbeu i Shkupit, Tuz efendiu, thotë narratori, "jo vetëm që s'ishte tunduar asnjë çast nga mendime të pafytyra, si kalimi i natës në të, pale pastaj t'i shkonte mendja në turpe të tilla, si mbetje shtatzënë grash e lemerira të tjera, por edhe kryet për ta parë keshtjellën e kishte kthyer gjithë kujdes, i trembur".
Përderisa ekspedita turke e udhëhequr nga Tuz efendiu kërkon varrin e Kastriotit, shkrimtari, ngadalë dhe mjeshtërisht, e fut atë në kurthin e enigmës, duke e ngritur në piedestalin më të lartë shenjtërinë e figurës së Kastriotit. I ballafaquar me këtë mynxyrë, Tuz efendiu që në fillim të detyrës e kupton se misioni i tij ishte shumë i vështirë dhe i pamundur. Duke kaluar nëpër bujtina dhe duke biseduar rreth Shqipërisë, ai turbullohet dhe kupton se puna e tij ishte utopike. Ndonëse përvojat e tij të mëparshme me shërbime të ndërlikuara ishin të shumta, ky me varrin ua kalonte të gjithëve, sepse "dukej që ishte fjala për një varr tepër të rëndësishëm, atë të Kastriotit". Ai sa më shumë që merr informatat rreth varrit për të cilin duhej të hartonte raportin e fshehtë aq më shumë bëhet konfuz dhe sa më shumë që e kupton këtë punë të ndërlikuar aq më shumë turbullohet, meqë i "vdekuri paskësh qenë armiku numër një i shtetit osman". Në krye të detyrës së rëndë, ai vërtet s'e ka të qartë pse duhet të bëhej një gjë e tillë, për më tepër, ai s'e di ç'leverdi kishte shteti nga kjo aventurë. Duke u përpëlitur para sfidave që ka përpara, ai nuk di nëse ishte mirë për shtetin të gjendeshin ata eshtra apo jo. Dhe dilema bëhet hamletiane: "Në i gjetsha, ka rrezik të më thonë: pse i gjete. E në s'i gjetsha, prapë mund të më thonë pse." Në këtë gjendje të amullt, pa shpresë, pa vetëbesim, ai mbërrin në Lezhë, te varri i zbrazët, tek thelbi, tek enigma. Për ta shpjeguar brendinë e varrit të Kastriotit, narratori, që di gjithçka në tekst, Tuz efendiun e vë përballë një prifti, ndërkaq mes tyre është mungesa e varrit. Për turkun kjo zbrazëti është e skëterrshme, një boshllëk që i ngjallë frikë, trishtim, ndërkaq për të dytin një gjë krejt e natyrshme.
Takimi i Tuz efendiut me varrin është i makthshëm dhe ky moment përshkruhet kështu në tekst: "Sipër gropës ishin vendosur dy dërrasa, mbi të cilat mbikëqyrësit e shitmë kishin kaluar, më sa dukej, nga njëri krah në tjetrin, me shpresë se duke e parë zbrazëtinë nga këndë të ndryshme, diçka do të kuptonin. Tuz efendiu bëri të njëjtën gjë dhe u bind se sa më shumë ta vështroje atë zbrazëti, aq më e shkretë të dukej vetja." Përballë kësaj shkretie që i shkakton enigma e varrit, ai kujton porositë e këshilltarit të fshehtë të vezirit të madh, se e fshehta që "ndryn ai varr", të gjithë ata që kanë shkuar te varri i ka kthyer të trullosur dhe të dështuar. Tuz efendiu, pasi e lexon kronikën Merhum Defterin, në vend që të qartësonte misionin e tij, bëhet edhe më konfuz, më i shkretë, meqë të dhënat për varrin, vjedhja e eshtrave nga ushtarët për t'i përdorur si hajmali, marrja e turpit të tij nga princat e tjerë, nga gruaja që s'u bë mbretëreshë, ishin kontradiktore po aq sa misioni i tij dhe në këtë dramë shpirtërore, ai vetëm për një gjë është i sigurt: "E fshehta e varrit, sa vinte bëhej shqetësuese." Për të varri ndryn një të keqe dhe ishte pikërisht ajo e keqe që ia prishte gjumin e perandorisë, Vezirit të rendit dhe vizionit turk për ta thyer Europën, në të cilën përpjekje Gjergj Kastrioti ishte digë e pakalueshme.
Tuz efendiu duke lexuar Merhum Defteri, kupton për një varr tjetër, të gjeneralit Ballaban, jeniçer shqiptar që kishte ngulur flamurin turk në murin e Kostandinopolit. Jemi përpara një shemrim varresh dhe ai kupton se në jetën shqiptare bëhej fjala për "dyvarri" dhe pikërisht nga kjo enigmë varej gjithçka, meqë "këndej e tutje historia shqiptare do të përcaktohej, me sa dukej, nga ndeshja midis dy varreve, të zbrazëtit dhe të plotit".
Kur lexuesi ndalet te ky paragraf, ndien peshën e rëndë historike që peshon në këtë fjali dhe thirrjen që autori i bën atij për të shmangur dyzimet fatale historike.
Të dhënat historike në tekst janë të pakta, thjesht janë evidenca sporadike që përdoren për të treguar itinerarin e mëtejmë të Tuz efendiut i cili hetim pas hetimi, mbërrin te kisha katolike, atje ku princërit shqiptarë kishin lidhur besëlidhje për të luftuar perandorinë.
Por teksti ka një kontekst të fortë, një nënshtresë filozofike, me shenja dhe simbole që lexuesit i flasin për fatin e përhershëm të kombit shqiptar dhe rrugëtimit të tij historik, nëpër batica dhe zbatica, përballjes së herëpashershme me filozofinë e "dyvarrisë". Në këtë përplasje autori bën një prerje cezariane kulturore dhe flet qartë për transformime historike e antropologjike, për shprehjen "robt e shtëpisë" që zëvendësonte shprehjen e vjetër abrnore, "gjindja e shtëpisë". Në këtë tekst letrar Kadareja e rikthen historinë si domosdoshmëri, si pikënisje kulturore, ndërsa Kastriotin si gjuhë, mendim dhe vizion për të ardhmen. Ai lundron thellë në psikologjinë historike të shqiptareve dhe prek nyjat nevralgjike të cilat, për hir të një politike korrekte, ndonjëherë nga studiues dhe shkrimtarë janë trajtuar vetëm sipërfaqësisht. Kadareja s'e dëshiron këtë. Përkundrazi, ai kërkon qartësinë dhe sipas tij kjo ndërlidhet me heroin kombëtar, prandaj ai kërkon të kultivohet kujtesa historike që lexuesi i sotëm dhe i nesërm të mos fundoset në kurthet e saj. I vetëdijshëm për planet e përhershme të pushtuesve që, duke mbjellë frikë, ata një ditë duan të mbërrijnë te momenti i sikletshëm, të "…shpresonin që një ditë të shtypurit do t'i donin sunduesit. Madje të kishin mall për ta, saqë, po të vinte dita që ata të iknin, t'u thoshin: mos! Mos na lini. Ose: kthehuni prapë".
Itinerari i Tuz efendiut kulmin e arrin kur ballafaqohet drejtpërdrejt me varrin. Një pasdite të zymtë për të ai e kalon me priftin Gjon Ndreca, me të cilin biseda vente nga s'vente e rikthente te varri i zbrazët, ai i Krishtit dhe meshtarit, zbrazëtia s'i shkaktonte ndonjë brengë, ndërkaq të parin kjo e mpinte, e trulloste dhe e trishtonte. Përmes një ligjërimi të qetë, të prajshëm, autori e përshkruan zbulimin e enigmës dhe kjo bëhet me ngulmimin e Tuz efendiut që, pavarësisht ankthit që i shkakton, i do të kuptojë enigmën e varrit të Krishtit dhe të nxjerrë analogjitë me varrin e Gjergj Kastriotit.
Kadareja te kjo novelë e qëmton ekzistencën shpirtërore të kombit shqiptar dhe për të realizuar këtë, ai përdor metodën e simbolizmit dhe të analogjisë së personazheve. Gjergj Kastrioti nuk është hero historik i rëndomtë, siç mund të jenë të tjerët. Ai është një ide e thadruar në ndërgjegjen shqiptare dhe nuk mund të shqitet nga ai, për aq sa mund të shqitet Krishti nga krishterimi. Kjo analogji kaq domethënëse, njëherësh kaq e guximshme për t'u përdorur, e bën Kadarenë krejt të veçantë në trajtimin e figurës së heroit tonë kombëtar.
*/exlibris.al*



# Çudia për Huan Rulfon



**Nga: Gabriel Garcia MARQUEZ**
**Përktheu: Bajram KARABOLLI**

Zbulimi i Juan Rulfos – si ai i Franc Kafkës – pa dyshim, do të jetë një kapitull themelor në kujtimet e mia. Kisha mbërritur në Meksiko më 2 korrik 1961, pikërisht ditën që Ernest Heminguej i dha fund jetës me një të shtënë. Unë, jo vetëm nuk i kisha lexuar librat e tij, por as që kisha dëgjuar të flitej për të. Jetoja në një apartament pa ashensor, në rrugën Renan, në lagjen Anzures. Kishim një dopio dyshek, për sheshi, në një dhomë gjumi të madhe, një djep në dhomën tjetër, ndërsa në mesore një tavolinë për të ngrënë e për të shkruar dhe dy karrige të vetme që na shërbenin për gjithçka.
Kishim vendosur të qëndronim në këtë qytet i cili ende ruante një përmasë humane, me një ajër të tejdukshëm dhe me bulevardet plot lule me ngjyra të dalldisura, por autoritetet e emigracionit nuk po na i bënin të mundur gëzimin tonë. Kësisoj, gjysma e jetës, aty, do të na kalonte duke qëndruar në radhë, pa lëvizur e nganjëherë në shi, në oborre të mërzitshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
Unë atëherë isha 32 vjeç dhe kisha bërë në Kolumbi një karrierë jetëshkurtër gazetareske; kisha kaluar nja tre vjet shumë të dobishëm dhe të ashpër në Paris, nja tetë muaj në Nju-Jork, dhe doja të bëja skenarë filmash në Meksiko. Bota e shkrimtarëve meksikanë në atë kohë ishte e ngjashme me atë të Kolumbisë dhe u ndjeva shumë mirë midis tyre. Gjashtë vjet më parë kisha botuar romanin tim të parë "Gjethnaja" dhe kisha tre libra të tjerë gati për botim: "Koloneli nuk ka kujt t'i shkruajë", që doli më pas në Kolumbi; "Ora e keqe", që u botua nga Shtëpia Botuese "Era", pak kohë pas kërkesës së Visente Rojos, dhe vëllimin me tregime "Funeralet e nënëmadhes". Kësisoj, unë isha një shkrimtar me pesë libra klandestinë, por problemi im nuk ishte ky, sepse, as atëherë e as ndonjëherë tjetër nuk kam shkruar për të qenë i famshëm, por që miqtë e mi të më donin më shumë, gjë që besoja se do ta arrija.
Problemi im i madh si romancier ishte se pas këtyre librave ndihesha sikur të qenkësha futur në një rrugicë pa krye dhe po kërkoja me ngulm një shteg për të dalë. Njoha plot autorë të mirë dhe të këqij, të cilët mund të më tregonin rrugën e, megjithatë, ndihesha se po vija vërdallë në rrathët bashkëqendrorë, pa e përfillur lodhjen; përkundrazi, ndieja se ende më mbeteshin mjaft libra pezull, veç nuk po gjeja dot një mënyrë bindëse dhe poetike për t'i shkruar. Isha në këto andralla kur Alvaro Mutis, me hapa të gjatë, ngjiti të shtatë katet e pallatit tim me një pako librash në dorë, prej të cilave nxori librin më të vogël dhe, duke u shkrirë në gaz, më tha: "Dreqi ta marrë, lexoje këtë mashtrues, nëse do të mësosh!". Ishte "Pedro Paramo".
Atë natë nuk vura gjumë në sy, derisa e mbarova së lexuari për të dytën herë; qysh nga nata e tmerrshme kur, nja dhjetë vjet të shkuara, kisha lexuar "Metamorfozën" e Kafkës, në një bujtinë të kobshme studentësh të Bogotasë, kurrë nuk kisha përjetuar një tronditje të ngjashme. Të nesërmen lexova vëllimin me tregime Rrafshina në flakë dhe u çmerita njëlloj. Shumë më vonë, në paradhomën e një konsultoreje, në një revistë mjekësore, gjeta tregimin kryevepër të Rulfos, "Trashëgimia e Matilda Arkanhelit". Pjesën tjetër të atij viti nuk munda të lexoj asnjë autor tjetër, sepse të gjithë më dukeshin kot.
Ende nuk më qe fashitur trandja, kur dikush i tha Karlos Velos* se unë qenkësha i aftë t'i recitoja përmendsh paragrafë të tërë nga "Pedro Paramo". E vërteta ishte edhe më: mund të recitoja komplet librin nga fillimi në fund dhe anasjelltas, pa ndonjë gabim të ndjeshëm, madje, mund të thosha se në cilën faqe të botimit që kisha unë gjendej çdo episod dhe nuk kishte tipar të karakterit të secilit personazh që të mos e njihje në thellësi.
Më vonë, Karlos Vela dhe Karlos Fuentes më ftuan që bashkë me ta të bënim rishikimin kritik të adaptimit të parë të "Pedro Paramos" për film. Kishte dy probleme të qenësishme: së pari, ishte puna e emrave. Sado subjektive që duket, çdo emër, në një farë mënyre, i ngjan atij që e mban dhe kjo është shumë më e dukshme në fiksion sesa në jetën reale. Huan Rulfo ka thënë, ose ia kanë bërë të thënë, se i vinte emrat e personazheve të tij, duke lexuar gurët e varreve nëpër varrezat e Haliskos; e vetmja gjë që mund të thuhet me siguri, është se nuk ka emra të përveçëm më të veçantë se ata të njerëzve në librat e tij; mua më dukej e pamundur, dhe vazhdon ende të më duket ashtu, se nuk mund të gjeja kurrë një aktor që të identifikohej, pa asnjë mëdyshje, me emrin e personazhit të tij.
E keqja e këtyre shqyrtimeve të këndshme është se kokëfortësitë e frymëzimit nuk janë gjithmonë të njëjtat nga arsyeja. Muajt kur ndodhën disa fakte janë thelbësore për analizën e veprës së Huan Rulfos dhe unë dyshoj nëse ai ka qenë i vetëdijshëm për këtë. Në punën poetike – dhe "Pedro Paramo" është i tillë, në shkallën më të lartë – autorët zakonisht thërrasin muajt për zotime të ndryshme me saktësi kronologjike; edhe më: në plot raste ndryshohet emri i muajit, i ditës, madje edhe i vitit, vetëm e vetëm për t'iu shmangur një rime të papërshtatshme apo dëgjimit të një kakofonie, pa menduar se këto ndryshime mund ta çojnë në një kritikë apo në një ngatërresë përfundimtare. Kjo ndodh jo vetëm me ditët dhe muajt, por edhe me lulet; ka shkrimtarë që nuk merren me to, me rëndësinë e vërtetë të emrave të tyre, duke mos u thelluar fare nëse përshtaten me vendin apo stinën; kësisoj, nuk është çudi të lexosh libra të mirë ku gjen të lulëzojnë lulemëllaga në rërë dhe tulipanë në dëborë. Te "Pedro Paramo", ku është e pamundur të përcaktosh në mënyrë përfundimtare kufirin midis të vdekurve dhe të gjallëve, përpikëritë janë edhe më kimerike, askush nuk mund të dijë në të vërtetë se sa zgjatin vitet e vdekjes.
I rendita këto pak rreshta, për të thënë, në fund të fundit, se shqyrtimi deri në thellësi i veprës së Huan Rulfos, tek e mbramja, më hapi rrugën për të kërkuar vazhdimin e librave të mi dhe, mu për këtë, e kisha të pamundur të shkruaja për të, pa m'u dukur se e gjitha kjo ishte për mua vetë. Tani po ju them se u ktheva për ta rilexuar edhe një herë gjithë veprën e tij për të shkruar këto shënime të shkurtra nostalgjike, duke u bërë kështu edhe një herë viktimë e pafajshme e së njëjtës çudi, si në rastin e parë; nuk janë më shumë se 300 faqe, por janë, këtë e besoj plotësisht, aq të përjetshme sa ato që njohim nga Sofokliu.
Nëse unë do të kisha shkruar "Pedro Paramon", nuk do të merrja kurrë guximin të kthehesha e të shkruaja përsëri në jetën time.*/literal.media/*

# Gruaja që e arsimoi kombin

Daut DAUTI

Autobiografia e Sevasti Qiriazit e titulluar "Jeta ime" është ndër veprat më të mira të historisë shqiptare të periudhës së Rilindjes. Libri fillimisht është shkruar në anglisht kurse në shqip është botuar në vitin 2016. Ky është një libër që duhet ta lexojnë të gjithë dhe të përfshihet si tekst i obligueshëm shkollor.

Jeta e Sevastisë, një gruaje të jashtëzakonshme, është tregim i historisë shqiptare. Është tregim i vullnetit, patriotizmit dhe vështirësive të mëdha që ka patur rruga e krijimit të kombit nëpërmes gjuhës, gjegjësisht arsimit. Në realitet, kombet nuk janë krijuar pa sakrifica. Por, këtu kemi të bëjmë me punën dhe sakrificën e një gruaje e cila ka qenë më e madhe se ajo e burrave. Fjalia e parë që përmban ky libër biografik, e shpjegon karakterin e autores e cila në pozitën e heroinës u ngjit duke qenë studentja dhe mësuesja e parë e gjuhës dhe shkollës shqipe. Këto fjalë i ka zgjedhur Sevastia për fillim të librit biografik të saj:

"Unë jam shqiptare. Ky përbën faktin më të rëndësishëm të jetës sime, madje më të rëndësishëm se edhe familja, pasi të qenët e ndërgjegjshme për të më krijoi ndjesinë e gjallë të asaj që duhet të bëj duke i dhënë kështu qëllim jetës sime".

Kjo forme e të shkruarit njihet si: të thuash shumë me pak fjalë. Në parathënie të librit Sevastia e tregon qëllimin e saj të jetës si mësuese. Qëllimi është përgatitja e popullit shqiptar për vetafirmim kombëtar, promovim të ndjenjave të vëllazërisë mes myslimanëve dhe të krishterëve dhe inkurajimi për punë të përbashkët për liri e pavarësi. Shkolla duhet të ketë një qëllim.

Si çdo biografi, edhe kjo fillon nga fëmijëria. Por, pjesa më interesante është koha e studimeve të saja në Stamboll. Sevastia ka një rrëfim interesant që lidhet me interesimin për patriotët që e ka titulluar "Aventura e parë" në kapitullin pestë. Sevastia shkruan se si kishte marrë vesh për Koto Hoxhin, një patriot shqiptar që gjendej në burg në Stamboll. Ajo hulumton se në cilin burg gjendet Koto. Pasi e gjen burgun, zbulon se drejtori, Qamil Efendiu, është shqiptar. Pastaj, e gjen adresën e shtëpisë së drejtorit dhe i shkon në shtëpi, kinse rastësisht, sikur shqiptarët që shkojnë te njëri-tjetri në kurbet. Shoqërohet me gruan e drejtorit, e cila krijon respekt të madh për Sevastinë, sikur edhe Qamil Efendiu më vonë. Por, një ditë Sevastia bën një veprim të paimagjinueshëm. Shkon në burg në zyrën e Qamil Efendiut e veshur 'tebdil' me rroba të burrave. Megjithatë, Qamil Efendiu e njeh dhe kërkon që ajo ta sqaronte këtë. Sevastia e shpalos qëllimin e saj dhe kërkon që ta vizitojë Koton e cila gjë i lejohet përkundër ndalesës. Por, këtu e kemi situatën që tregon se shqiptari nuk mund ta refuzojë shqiptarin edhe në momente të rrezikshme. Pason vizita dhe përshkruhet biseda me karakter patriotik.

Sevastia nuk ka pasur mundësi pa e përshkruar edhe një situatë tjetër të rëndësishme të jetës së saj në Stamboll. Është dita e ceremonisë së përfundimit të studimeve në shkollën e famshme, "Robert College". Dhe, kush i ka shkuar Sevastisë në këtë ditë të rëndësishme? Vëllezërit Frashëri. Që të tre. Ky është momenti i saj më i rëndësishmi në jetë. Tre inspiruesit më të rëndësishmit që ka patur ajo ndonjëherë. Ky është momenti më i bukur i librit. Naim bej Frashëri, komisioner perandorak i arsimit, e siguron lejen për hapjen e shkollës së parë shqipe për vajza ku do të vepronte Sevastia. Pjesa tjetër është histori, siç thuhet.

Puna e shkollës në Korçë nuk është e lehtë, por entuziazmi dhe dashuria për mësim është i madh. Megjithatë, shkolla përparon, por në vitin 1913 e mbyllin grekët. Peshkopi i kishës greke bënë thirrje publike për vrasjen e shqiptarëve. Madje, ai thirrjen e bënte me anë të këngës që Sevastia e mban në mend si refren tmerri:

*Ngrihuni, o ju të pafajët fëmijë të mi!*
*Ngrihuni e vrisni babanë e birin e tij!*
*Besë mos tregoni për asnjë të nënshtruar,*
*Kjo fqinjin tënd grek ka për ta gëzuar.*

Por, Sevastia dhe Qiriazët tjerë, nuk dorëzohen dhe shkollën e hapin sërish në Tiranë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore keqësohet gjendja. Në vitin 1943 gjermanët i internojnë Qiriazët në një kamp të përqendrimit në Batajnicë të Beogradit. Pas një viti, kampi sulmohet nga aviacioni i aleatëve dhe Qiriazët, pas shumë mundimeve dhe peripecive, ia dalin të kthehen në Kamëz. Ajo që ndodhë më Sevastinë, në kohën e 'lirisë' dhe regjimit komunist, është një tmerr që sot duhet të na turpërojë të gjithëve. Në vitin 1946, Sevastisë ia burgosin dy djemtë. Ata akuzohen se janë fajtorë për shkak se kanë të kryer universitete amerikane. Në vitin 1949, njëri nga djemtë, Gjergji, thuhet se bën vetëvrasje në burg. Sevastia e kërkon trupin e tij, por kot. Nga dëshpërimi, Sevastia vdes pas gjashtë muajve duke hyrë edhe ajo në listën e "armiqve" të shtetit.

Kufoma e saj u bart në karrocë të tërhequr nga një kalë kurse kotezhi përmbante vetëm ata pak anëtarë të familjes që kishin mbetur. Ky ka qenë fundi i mësueses së parë me përgatitje universitare, gruas që luajti rol kryesor në procesin e formimit të kombit dhe shtetit. Në varrimin e gruas më të rëndësishme që kishte kombi, askush nuk mori pjesë. Kjo ka qenë fytyra e komunizmit shqiptar.

/Telegrafi/



E jashtëzakonshme

# Dasma më e çuditshme në botë: Pa çiftin, dasmorët festojnë në livestream



Martesat nuk shkojnë gjithmonë ashtu siç planifikohen, por teksa shpërthimi i koronavirusit vazhdon të rritet, një dasmë u zhvillua pa praninë e dhëndrit dhe nuses. Çifti nga Singapori, Joseph Yew dhe Kang Ting, u rikthyen nga një udhëtim në Kinë, pak ditë para martesës së tyre. Kur të ftuarit shprehën shqetësime për pjesëmarrjen, çifti gjeti një mënyrë për t'i qetësuar. Vetë çifti nuk mori pjesë në dasmë, por nëpërmjet një komunikimi direkt me video përshëndetën të ftuarit dhe mbajtën një fjalim, shkruan "BBC".

FOTO E DITES



Fotografi nga bjeshkët e Roshkodolit në stinën e dimrit

E rrallë

# Miliarderi befason kamerieren





Pasi pa një "sfidë të bakshishit" në "Facebook", miliarderi i zonës së Bostonit, Ernie Boch, vendosi ta çojë atë në nivelin tjetër. Sipas mediave të huaja, Boch vendosi të linte një bakshish prej 5 000 dollarëve. "Kamerierët dhe kamerieret, ata janë njerëz kaq të mirë", ka thënë Boch për CBS Boston.

## BARSOLETA E DITËS



**Dy binjakë, para lindjes, i thonë njëri-tjetrit:**
**- Mos dil njëherë jashtë se, si duket, po bie shi!**
**- Ku e more vesh ti?**
**- Paj, ky që na vizitoi më parë kishte të veshur mantel gome.**

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00

### Spies in Disguise 3D



I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min

**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.

**Regjia:** Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D



Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min

**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj

**Regjia:** J.J. Abrams



Çdo natë në ora 22:30

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Është një çast shumë i mirë për ju që të jeni në qendër të vëmendjes dhe ta rrëmbeni pjesën që ju takon sot.



**DEMI**
Ju rrezikoni ta humbni identitetin duke u bërë gjysma e një çifti dhe kjo nuk është mirë. Ngadalësoni ritmin sot.



**BINJAKËT**
Sot duhet të tregoheni të fshehtë në lidhje me disa informacione që shkaktojnë telashe për disa persona të afërt.



**GAFORRJA**
Sot nëse keni një pyetje ose shqetësim për një çështje të caktuar, kërkoni ndihmë nga dikush.



**LUANI**
Do të takoheni me dikë nga një sfond tërësisht i ndryshëm sot dhe ai mund të kenë diçka serioze për të thënë që duhet t'i kushtoni vëmendje.



**VIRGJËRESHA**
Sjelljet e mira janë gjithmonë të përshtatshme, por jo hapja e zemrës me të gjithë nuk është. Dijeni ndryshimin sot.



**PESHORJA**
Nëse ndiheni i intimiduar nga një person, atëherë ka ardhur momenti që të përballeni me të.



**AKREPI**
Nëse tani po përpiqeni të afroheni me dikë, mos harroni se romanca supozohet të jetë diçka që sjell argëtim në jetën tuaj.



**SHIGJETARI**
Tani për tani gjithçka që dëshironi është një filxhan i mirë kafeje dhe një karrige e rehatshme ku mund të uleni dhe të lexoni një libër.



**BRICJAPI**
Sot është momenti për ta eksploruar anën tuaj krijuese dhe muzika mund të jetë një katalizator i nevojshëm.



**UJORI**
Është koha të kuptoni se duhet të ecni më tej. Sa më shumë energji të harxhoni për dikë që nuk përgjigjet, aq më pak energji keni për të zbuluar interesa të reja.



**PESHQIT**
Sot mund të ndiheni në siklet në lidhje me ndjenjat e dikujt ndaj jush. Është e këshillueshme që të flisni me këtë person.

# Meghan dhe Harry e kalojnë verën në Los Angeles?



Duket se planet verore të Meghan Markles dhe Princit Harry po shkojnë duke u sofistikuar. “Atyre u pëlqen të jenë në Kanada, por janë në kërkim edhe të shtëpive në Los Anxhelos”, ka pohuar një person i afërt me ta për revistën “People”. “Me gjasë kanë shtëpi në të dyja vendet”. Revista, po ashtu, raporton se çifti i famshëm do ta kalojë verën në Los Anxhelos. Për ata që nuk e dinë, Meghan është lindur në LA dhe nëna e saj, Doria Ragland, jeton atje. Ajo, gjithashtu, ka disa miq ende në këtë zonë dhe një sistem mbështetës të shkëlqyeshëm në Bregun Perëndimor.

# Ronaldo feston ditëlindjen




Cristiano Ronaldo të mërkurën ka festuar 35-vjetorin e tij dhe këtë e ka bërë me dije partnerja e tij Georgina përmes disa postimeve në “Instagram”. Fillimisht ajo postoi një foto në “Instastory” të Ronaldos me një tufë trëndafilash të bardha në dorë dhe i shkruan një urim të ëmbël. “Për 1000 vjet të tjera krah teje, të duam babi”.



# Jennifer Lopezi ndan me adhuruesit momentin e fundit të performancës në ‘Super Bowl’

Këngëtaret e njohura, Shakira dhe Jennifer Lopez, ishin të mrekullueshme gjatë performancës së tyre në ‘Super Bowl’ të dielën. Lopez në “Instagram” ka publikuar momentin e fundit të tyre gjatë performancës. “E dua këtë moment me Shakirën disa çaste pas përfundimit të performancës”, ka shkruar Lopezi.

# Ndërron jetë në moshën 103-vjeçare legjenda e Hollywoodit, Kirk Douglas



Aktori Kirk Douglas, që kishte karrierë shtatëdekadëshe në Hollywood, ka ndërruar jetë në moshën 103-vjeçare. Ai kishte luajtur disa role të njohura si skenë dhe ekrane, përfshirë klasikun e 1960-s, “Spartacus”, në të cilin kishte luajtur rolin kryesor, shkruan BBC. I lindur në Nju Jork më 1916 ai kishte spikatur gjatë “epokës së artë” të Hollywoodit, ku dhe kishte marrë nominimin e parë për Oscar me filmin “Champion” më 1949. Ai është babai i fituesit të Oscarit, aktorit Michael Douglas.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi Servisimi Parosi

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Fetahaj: Dukagjini i rrezikshëm, por Ballkani kualifikohet në gjysmëfinale

Ballkani të dielën i shkon Dukagjinit në Klinë në kuadër të çerekfinales së Kupës. Liridon Fetahaj për "Epokën e re" ka thënë se pret fitore në këtë ndeshje. "Mendoj se skuadra e Dukagjinit është shumë më e fortë se në vjeshtë dhe renditja e saj në tabelë nuk tregon realitetin, prandaj nuk do të jetë aspak lehtë ndaj saj. Ne jemi të përgatitur maksimalisht dhe me një angazhim nga të gjithë lojtarët shkojmë në Klinë për të fituar dhe kualifikuar në gjysmëfinale", ka thënë Fetahaj



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 SHKURT - Kampioni vjeshtor në IPKO Superligën e Kosovës në futboll, Ballkani nga Suhareka, është gati për sezonin pranveror. Kështu ka bërë me dije të enjten për gazetë Liridon Fetahaj. "Faza përgatitore ka shkuar shumë mirë në Antalia, ku jemi përballur me kundërshtarë shumë të fortë dhe e kemi testuar veten. Ne si klub jemi gati për sezonin pranveror dhe besoj se do të jemi të suksesshëm ashtu sikurse në vjeshtë", ka thënë Fetahaj, i cili beson se në pranverë do të ketë më shumë minuta në dispozicion. "Konkurrenca është e madhe te Ballkani, ku në çdo pozitë kemi nga dy lojtarë të fortë, por patjetër se pres të kem minuta më shumë. Kjo dihet se varet nga puna ime, forma dhe besimi i trajnerit", ka shtuar ai.

Ballkani është një prej favoritëve kryesorë për titull, por Fetahaj sheh edhe disa skuadra të tjera të forta që do t'i bëjnë konkurrencë Ballkanit në garën për trofeun e më të mirit në Kosovë. "Ne jemi shpallur me meritë kampionë të vjeshtës dhe kemi treguar lojëra shumë të mira, kurse ne do të shkojmë ndeshje pas ndeshje, pasi nuk kemi diferencë të madhe me skuadrat e tjera që kërkojnë titull. Pretendente, përveç Ballkanit, i shoh edhe Prishtinën, Gjilanin, Dritën, Feronikelin dhe Llapin", ka shtuar ai.

Skuadra e drejtuar nga Ismet Munishi nuk ka pasur vetëm sezon të mirë në kampionat, por edhe në garën e Kupës, ku ka arritur me plot meritë në çerekfinale. Kjo skuadër ndeshjen e parë në sezonin vjeshtor e zhvillon në fundjavë kundër Dukagjinit për Kupë, derisa Liridon Fetahaj beson në sukses. "Mendoj se skuadra e Dukagjinit është shumë më e fortë se në vjeshtë dhe renditja e saj në tabelë nuk tregon realitetin, prandaj nuk do të jetë aspak lehtë ndaj saj. Ne jemi të përgatitur maksimalisht dhe me një angazhim nga të gjithë lojtarët shkojmë në Klinë për të fituar dhe për t'u kualifikuar në gjysmëfinale", ka thënë Fetahaj.

Ballkani nga shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar dhjetë fitore, katër barazime dhe tri humbje, duke u pozicionuar në vendin e parë me 34 pikë.

## SHKURT

### Besa angazhon trajner francez, Tanguy Fleury

Skuadra e Besës është duke synuar rikthimin në IPKO Superligën e Kosovës në futboll. Klubi pejan e ka angazhuar francezin Tanguy Fleury si trajner kondicional. "FC Besa ka arritur të angazhojë në kuadër të stafit teknik, trajnerin kondicional nga Franca, Tanguy Fleury, i cili vjen me një bagazh të lartë profesional. Trajneri kondicional është angazhuar menjëherë me klubin në Ulqin dhe qëllimi i tij është që futbollistët e Besës të jenë fizikisht të përgatitur për stinorin e ri pranveror", thuhet në njoftimin e Besës.

### Kohfeldt: Rashica shënon nga çdo pozitë

Trajneri i Werder Bremenit, Florian Kohfeldt, e ka ngritur në qiell reprezentuesin e Kosovës, Milot Rashicën. Ky i fundit e shkroi emrin e tij në histori të klubit gjerman pasi ka shënuar gola në gjashtë ndeshje radhazi në Kupën e Gjermanisë. "Ai godet nga çdo pozitë, shënon nga çdo pozitë. Miloti ka punuar në mënyrë të jashtëzakonshme në fazën defansive. Rashica është rrezik për çdo mbrojtës dhe mbrojtje në Bundesligë", ka thënë Kohfeldt.

### Shaqiri, ende synim i Galatasarayt

Galatasaray nuk është dorëzuar për transferimin e yllit të Liverpoolit, Xherdan Shaqiri, pasi synon të bëjë ofertë në afatin kalimtar të verës. Galatasaray është kampion në fuqi i Superligës turke dhe synon të paraqitet në Ligën e Kampionëve edhe në edicionin e ardhshëm, prandaj po mendon për ndërtimin e skuadrës për edicionin e ri, ku klubi ka menduar për emra të njohur për t'i transferuar në afatin kalimtar veror. Në krye të listës është emri i Xherdan Shaqirit nga Liverpooli. Sipas gazetës italiane 'La Gazzetta dello Sport', Shaqiri do të largohet në verë nga Liverpooli drejt një skuadre ku do të luajë më shumë.

## Prishtina emëron Salihun drejtor menaxhues, Begollin drejtor sportiv

PRISHTINË, 6 SHKURT - Skuadra e Prishtinës ka njoftuar se bordi drejtues i klubit ka zgjedhur drejtorin menaxhues dhe drejtorin sportiv. I pari do të jetë Agim Salihu, jurist i diplomuar, kurse drejtor sportiv do të jetë ish-futbollisti i kësaj skuadre, Granit Begolli. "Për drejtor menaxhues është zgjedhur përfaqësuesi juridik si dhe ushtruesi i deritanishëm i detyrës së drejtorit, Agim Salihu, i cili është jurist i diplomuar nga Prishtina. Salihu është marrë me punë juridike duke punuar në institucione të nivelit lokal, kurse nga viti 2016 është pjesë e FC Prishtina, duke kryer punë dhe detyra të përfaqësimit të klubit tek institucionet e administratës dhe gjyqësorit. Kurse Granit Begolli është zgjedhur drejtor sportiv në FC Prishtina. I njëjti ka qenë ish-futbollist i skuadrës sonë si dhe trajner me licencë 'A', duke qenë trajner në U19 në Llap (kampion të Kosovës 2018/19) dhe ndihmëstrajner në Ferizaj (2017/18 duke u ngjitur në Superligë nga Liga e Parë)", thuhet në njoftimin e FC Prishtina. Salihu dhe Begolli kanë kontratë deri më 31. 12. 2020.

FC PRISHTINA 1922

## Kaka: Neymari mund ta fitojë ‘Topin e Artë’

PARIS, 6 SHKURT - Ish-mesfushori i Real Madridit dhe Milanit, Kaka, e ka fituar “Topin e Artë” në vitin 2007, para se dominimin në futboll ta merrnin Cristiano Ronaldo dhe Lionel Messi. Neymari, që konsiderohej ndër më të talentuarit që kishte futbolli, nuk ka arritur ta fitojë këtë çmim, duke qenë hije e Lionel Messit te Barcelona, ndërsa kalimi te PSG-ja e ka përcjellë me shumë lëndime. “A besoj se Neymari mund ta fitojë atë në vitin 2020? Ai është një nga lojtarët më të mirë në botë, nuk ka dyshime për këtë. Ajo që ka nevojë ai tani është të fitojë një titull me ekipin dhe të jetë protagonisti kryesor i kësaj arritje”, ka deklaruar Kaka.




# Sonte Ponte Prizreni - Ylli, të dielën derbi Peja - Bashkimi

PRISHTINË, 6 SHKURT - Java e 25-të e Superligës së Kosovës në basketboll do të sjellë shumë ndeshje interesante. Takimi i parë do të jetë ndërmjet Ponte Prizrenit dhe Golden Eagle Yllit vendit të tretë, përkatësisht të katërt. Prizreni ka 13 fitore dhe nëntë humbje, derisa Ylli 15 fitore dhe gjashtë humbje, ku nuk ka pësuar asnjë humbje në stinorin pranveror. Sonte (e premte) në mbrëmje do të përballen rivalët e vjetër, Sigal Prishtina dhe Trepça. Prishtinasit nga 21 ndeshje kanë 16 fitore dhe pesë humbje, kurse mitrovicasit pesë fitore dhe 16 humbje. Ndeshje interesante pritet të jetë edhe ajo ndërmjet Feronikelit dhe Lipjanit. Skuadra nga Drenasi ka pesë fitore dhe 16 humbje, aq sa Trepça dhe ka synim të jetë pjesë e elitës, kurse lipjanasit kanë një fitore dhe 21 humbje. Java e 25-të do të përmbyllet me derbin ndërmjet Pejës dhe Bashkimit. Peja ka 12 fitore dhe nëntë humbje, kurse Bashkimi 13 fitore dhe nëntë humbje. Të dyja skuadrat shpresojnë ta përmbyllin kampionatin sa më lart. Rahoveci pushon në këtë xhiro. Takimet zhvillohen të premten dhe të shtunën, për shkak se të martën fillon Final 8.




**SUPERLIGA - JAVA 25**

**Të premten takohen:**
17:00 Ponte Prizreni - Golden Eagle Ylli
19:00 Sigal Prishtina - Trepça

**Të shtunën takohen:**
17:00 Feronikeli - Lipjani
19:00 Peja - Bashkimi

# Clippersat dhe Denveri ‘kërcënojnë’ Lakersat, fiton Toronto

LOS ANXHELOS, 6 SHKURT - Skuadra e Clippersave, falë 23 pikëve të Georges dhe 23 të Shamet, fitoi me rezultat 128-111 ndaj Miamit. Mysafirët luajtën më mirë në pjesën e parë (Jones 25 pikë e 11 rebound), por në të dytën erdhi përmbysja e ekipit kalifornian, që e meritoi fitoren (24 tripikësha, rekord për Clippersat). Fiton edhe Denveri me rezultat 98-95 kundër Utah Jazzit, një përballje mes dy ekipesh pretendente në Perëndim. Të dyja skuadrat e kërkuan fitoren, por në fund triumfoi Nuggets, ku u dalluan Murray me 31 pikë dhe Jokiq me një “triple double” (30 pikë, 21 rebounde e 10 asistime). Fitore në sekondat e fundit për kampionët e Torontos, që e mposhtën me rezultat 119-118 Indianan, ndeshje me rivalitet dhe emocione. Indiana u shkëput deri në 18 pikë (Brogdon 24 pikë), por në fund erdhi përmbysja e ekipit kanadez me Lowry (32 pikë e 10 asistime), Ibaka (30 pikë) e Siakam (25 pikë). Pa probleme fitore ka arritur Bostoni, që e mundi me shifrat 116-100 Orlandon (Tatum 33 pikë), ndërsa Oklahoma triumfoi 109-103 ndaj Clevelandit (Schroder 30 pikë). Surprizon Memphisi që, falë një loje të mirë kolektive (6 lojtarë mbi 13 pikë), mundi 121-107 Dallasin (Porzingis 32 pikë).




**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Detroit - Phoenix | 116-108 |
| Boston - Orlando | 116-100 |
| Brooklyn - Golden State | 129-88 |
| Toronto - Indiana | 119-118 |
| Minnesota - Atlanta | 120-127 |
| Oklahoma - Cleveland | 109-103 |
| Dallas - Memphis | 107-121 |
| Utah Jazz - Denver | 95-98 |
| Clippers - Miami | 128-111 |

SHKURT

## Trepça ’89 mposhti Lirinë në Durrës

Dy skuadrat nga Kosova, Trepça ’89 dhe Liria, janë ballafaquar ndërmjet vete në Durrës të Shqipërisë në një ndeshje kontrolluese. Rezultati final ishte 2-1 në favor të klubit mitrovicas. Muja dhe Tema realizuan për ’89-shin, ndërkohë Muhoviq realizoi për prizrenasit. Ndeshja u karakterizua me shumë raste shënimi dhe me gola, madje pesë gola u anuluan për shkaqe të pozitës jashtë loje, katër për prizrenasit dhe një për ‘minatorët’.

## Ibra, gati për derbin ndaj Interit

Zlatan Ibrahimoviqi me shumë mundësi do të jetë në fushë në derbin e të dielës në mbrëmje ndaj Interit. Suedezi nuk ishte në dispozicion ndeshjen e kaluar dhe kuqezinjtë nuk shkuan më shumë se barazimi ndaj Veronës. Tashmë Ibrahimoviqi do të rikthehet të stërvitet me grupin dhe duket se e ka marrë veten. Sulmuesi ka qenë edhe një ogur i mirë për Milanin, duke qenë se skuadra u është rikthyer sukseseve me Ibrën. Në këtë mënyrë, Interi do të ketë një problem më shumë për Antonio Conten, që duhet ta gjejë mënyrën për ta mbuluar bomberin suedez.

## Ronaldo: Juve ma jep mundësinë sërish ta fitoj Ligën e Kampionëve

Cristiano Ronaldo pretendon se Juventusi i jep atij mundësi ta fitojë një trofe tjetër në Ligën e Kampionëve, duke thënë se një gjë e tillë është e mundur me ekipin aktual të bardhezinjve. 35-vjeçari i ka shënuar 22 gola në 28 ndeshje dhe së fundmi e ka gjetur formën më të mirë. Ai e ka pranuar se synimi i tij është ta fitojë edhe një trofe tjetër në Ligën e Kampionëve, i cili do të ishte i gjashti për të. “Fakti që luaj në Juventus më jep mundësi ta fitoj atë përsëri. Ne e dimë që është e vështirë, sepse varet në shumë faktorë, por është e mundur sepse ne kemi ekip të mirë. Duhet të ecim përpara hap pas hapi”, ka thënë Ronaldo.

## Guardiola paralajmëron largimin e Messit nga Barça

Pep Guardiola beson se Barcelona është para një periudhe jo të mirë, e ngjashme me atë të Realit Madridit, kur u largua Cristiano Ronaldo. Një përplasje publike me Eric Abidal i ka shtuar zërat për një thyerje të marrëdhënieve në mes të Lionel Messit dhe klubit blaurgan. Guardioal i cili njeh më së miri Messin dhe Barcelonën paralajmëroi se klubi spanjoll duhet ta përgatitë veten për largimin e mundshëm të lojtarit më të mirë në botë. “Është e pashmangshme, këta lojtarë janë kaq të rëndësishëm për një skuadër, sa kur largohen, lënë hapësira të mëdha. Kur Messi të largohet nga Barcelona klubit do t’i duhet ca kohë për t’u rirregulluar. Është e pashmangshme. Ju e patë se çfarë ndikimi negativ pati largimi i Ronaldos nga Real Madridi. Si të mos ndihet mungesa e këtyre lojtarëve që shënojnë 40 ose 50 gola në sezon”, u shpreh Guardiola. Kujtojmë se Guardiola kaloi më shumë se 20 vjet te Barcelona si trajner dhe si lojtar.

## Prezantohet Yamaha, Rossi përgatit sezonin e lamtumirës

Të enjten është prezantuar motori japonez Yamaha, që pilotohet nga italiani Valentino Rossi dhe spanjolli Maverick Vinales. Ky i fundit ka siguruar rinovimin e kontratës deri në vitin 2022, ndërsa për legjendën italiane të Moto GP ky do të jetë sezoni i fundit me këtë motor. Yamaha ka konfirmuar se në vitin 2021 motorin e saj zyrtar do ta pilotojë francezi Fabio Quartararo (aktualisht me Yamaha Petronas), që do ta zërë vendin e Rossi. Duke folur për këtë ndryshim të madh të karrierës së tij, që mund ta çojë edhe nga tërheqja përfundimtare nga sporti, Rossi a thënë: “Ishte e vështirë ta merrje vendimin për të mos pilotuar Yamaha zyrtare në vitin 2021. Gjithsesi, për largimin tim përfundimtar ka ende kohë, por nëse nuk do të jem kompetitiv, do të largohem. Shpresoj që Yamaha e këtij viti të jetë kompetitive dhe të duelojë për titullin”. “Objektivi im është të garoj edhe në vitin 2021 dhe falënderoj Yamaha për mbështetjen që më dha, duke më ofruar një vend te Yamaha Petronas”, ka deklaruar 41-vjeçari italian.

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo -Tax Administration of Kosovo

## Njoftim për tatimpagues

### ATK, publikon formularët tatimor PD dhe CD

Administrata Tatimore e Kosovës, ju njofton se nga sot, në Sistemin Elektronik EDI, si dhe në formën manuale përmes ueb-faqes së ATK-së, mund të shkarkoni Formularin e deklarimit vjetor dhe pagesës për Tatimin në të Ardhurat Personale (PD) dhe Formularin e deklarimit vjetor dhe pagesës për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (CD), të cilët janë modifikuar.

Modifikimi/ndryshimi në formularët PD dhe CD, përfshinë:

- Zbritjet për sponsorizim në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë;
- Shumën obligative për pagesë;
- Mundësinë e parashtrimit të Kërkesës për Rimbursim;
- Mundësinë e përdorimit të pagesave tepër në këstet paradhënie për vitin vijues, si dhe në obligimet tjera të pashlyera;
- Shtimin e rubrikave, si: Llogaria bankare, Numri i llogarisë bankare dhe Mbajtësi i llogarisë.

Përmes formularit CD, tatimpaguesit të cilët kanë sponsorizuar në fushën e sportit, kulturës dhe rinisë duke plotësuar kushtet e përcaktuara me Ligjin për sponsorizimet, do të kenë mundësinë e zbritjes së atyre sponsorizimeve nga shuma obligative e tatimit për pagesë.
Gjithashtu, përmes këtyre formularëve (PD dhe CD), tatimpaguesit do të kenë mundësinë që të kërkojnë Rimbursim për pagesat tepër gjatë vitit apo nëse dëshirojnë mund të zgjedhin që pagesat tepër gjatë vitit t'i lënë parapagim me qëllim të mbulimit të obligimeve tjera të pashlyera ndaj ATK-së apo në pagesa paradhënie për vitin vijues.

Pra, me rastin e dorëzimit të formularit të deklarimit vjetor dhe pagesës së tatimit, nëse nga tatimpaguesi plotësohet rubrika "Kërkesë për Rimbursim", ATK do të pranoj kërkesën e tillë pa pasur nevojë që tatimpaguesi të dorëzoj edhe ndonjë kërkesë tjetër të veçantë për Rimbursim, mirëpo, në formular domosdoshmërish duhet të jenë të plotësuara edhe rubrikat "Llogaria bankare", "Numri i llogarisë bankare" dhe "Mbajtësi i llogarisë".

Ndërsa në rastin kur tatimpaguesi ka paguar më tepër gjatë vitit përmes késteve paradhënie dhe nuk plotëson rubrikën "Kërkesë për Rimbursim", ATK do të konsideroj se pagesat tepër do të përdoren për këste paradhënie për vitin vijues apo për mbulimin e obligimeve tjera të pashlyera ndaj ATK-së, që tatimpaguesi mund t'i ketë në atë moment apo edhe që mund t'i lindin në të ardhmen.

ATK, ju rekomandon që për shfrytëzimin e Sistemit Elektronik EDI, të përdorni shfletuesin e internetit **"Google Chrome".**

***ATK mban premtimin për kujdesin e vazhdueshëm ndaj tatimpaguesve!***

**Administrata Tatimore e Kosovës**

Komuna e Skenderajt

# NJOFTIM

**Për Shqyrtimin Publik të projekt-"Harta Zonale e Komunës (HZK-së) së Skenderajt 2020-2028"**

Komuna e Skenderajt (së bashku me kompaninë e angazhuar Vizion Projekt) dhe Programin për Zhvillim Gjithpërfshirës/ UN-Habitat-i kanë kënaqësinë të ftojnë qytetarët, shoqërinë civile, ekspertët, zhvilluesit, pronarët e tokave, komunitetet e ndryshme dhe të gjithë të interesuarit tjerë që të marrin pjesë në hapjen e Shqyrtimit Publik të projekt-"Harta Zonale e Komunës së Skenderajt 2020-2028". Me atë rast do të prezantohet dhe diskutohet zonimi i të gjithë territorit komunal së bashku me shfrytëzimin e tokës, kushtet e përgjithshme, kushtet ndërtimore; si dhe infrastruktura, vendbanimet joformale, planet rregulluese të hollësishme, etj.

**Takimi hapës mbahet më 14 shkurt 2020 (e premte) ora 10:30**
**Salla e Kuvendit – Komuna e Skenderajt**

I gjithë materiali (projekt dokumenti i HZK-së së bashku me hartat dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM)) do të jetë në dispozicion të të interesuarve për **30 ditë** rresht, **nga 14 shkurt deri më 16 mars**, në format e mëposhtme:

- Materialin e gjeni në vegëzën elektronike: https://kk.rks-gov.net/skenderaj/ ndërsa komentet mund të adresohen në e-mailin: **lirije.qerimi@rks-gov.net**
- Materialin në kopje fizike dhe sqarimet nga personeli i gjeni në **Ndërtesën e Komunës së Skenderajt, kati 3 tek Drejtoria e Urbanizmit** ndërsa komentet mund të shkruhen në librin që gjendet po aty;
- Peticionet në lidhje me projekt-HZK-në duhet të dorëzohen në Arkivin e Komunës së Skenderajt në katin përdhesë;
- Materiali do të prezantohet dhe komentet gjithashtu mundë të bëhen nëpër takimet në zonat rurale që do të organizohen si më poshtë:
  - Për vendbanimet Prekaz i Epërm, Prekaz i Poshtëm, Polac, Lubovec dhe Mikushnicë takimi do të mbahet në Prekaz të Epërm tek shkolla, me datë **18.02.2020 në ora 11.00;**
  - Për vendbanimet Klinë e Epërme, Klinë e Mesme, Klinë e Poshtme, Kuqicë, Tërrnave dhe Kotorr takimi do të mbahet në Klinë të Epërm tek shkolla, me datë **18.02.2020 në ora 13.30;**
  - Për vendbanimet LLaushë dhe Tushilë takimi do të mbahet në Llaushë tek shkolla, me datë **20.02.2020 në ora 11.10;**
  - Për vendbanimet Turiqec, Burojë, Kopiliq i Poshtëm, Kopiliq i Epërm, Vajnik, Rakinicë dhe Aqarevë takimi do të mbahet në Turiqec tek shkolla, me datë **20.02.2020 në ora 13.30;**
  - Për vendbanimet Likoc, Rezallë, Marinë, Murgë, Kryshevc, Ticë dhe Makërmal takimi do të mabahet në Likoc tek shkolla, me datë **25.02.2020 në ora 11.10;**
  - Për vendbanimet Qirez, Baks, Krasmirovc, Kozhicë, Krasaliq, Prelloc, Dashevc dhe Kralicë takimi do të mbahet tek shkolla me datë **25.02.2020 në ora 13.30;**
  - Për vendbanimet Runik, Çubrel, Vitak, Banjë, Pemishtë, Kostërc, Radishevë, Izbicë, Syriganë dhe Kllodernicë takimi mbahet në Runik tek shkolla me datë **27.02.2020 në ora 11.10;**

Harta Zonale është një dokument me karakter zonifikues dhe rregullues dhe pas aprovimit do të shërbejë si bazë për zhvillim fizik të territorit komunal. Procesin e planifikimit në tërësi e përkrahë edhe **Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)** me të dhëna dhe konsulencë.

Mirëpresim kontributin e qytetarëve në finalizimin e Hartës Zonale të Komunës së Skenderajt!

*Ky aktivitet mbështetet nga:* INCLUSIVE DEVELOPMENT PROGRAMME

*Program i implementuar nga:* UN HABITAT FOR A BETTER URBAN FUTURE, PAX, CBM

*dhe i financuar nga* SWEDISH DEVELOPMENT COOPERATION, SWEDEN



Berlin Chemie / A. Menarini Kosovo L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb. 71067858 me nr. Unik Identifikues 811159442.

Ndërmarrja publike N.P.L. ‘Prishtina Parking” sh.a. me seli në Prishtinë shpall të pavlefshëm certifikatën e regjistrimit të biznesit me numër: 71286274.

RESTAURANT
SWISS
TAVERNA
Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553
PRISHTINË





## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj kujdestare për vajzën 7 muajshe në Prishtinë. Për informata në tel: 044-444-009

▶ "Lux Dentima", SH.P.K. me numër të biznesit 810190249 me adresë në Prishtinë, Rr, Elbasanit p.n i njofton të gjithë debitorët dhe kreditore se ka marre vendim për zvogëlimin e kapitalit themelor, zvogëlimi i kapitalit themelor do të bëhet nga shuma fillestare 50000 (pesëdhjetë mije ) në 5000 Euro.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përballʼ "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

▶ Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

▶ Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

▶ Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

▶ Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

▶ Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo , ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet . Për info: 045/699-221.

▶ Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

▶ Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

Shes truallin prej 36 arë në fshatin Besi; 150 metra nga magjistralja Prishtinë-Besianë. Trualli ka gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe është shumë i përshtatshëm dhe për banim kolektiv. Po ashtu lëshojmë me qira vendin për restorant me një pamje atraktive dhe piktoreske me në një lartësi të madhe mbidetare. Tel. 044-413-197.


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues